



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 10 regjistër (JR)
Datë 15.02.2022

Nr. 12 i vendimit
Datë 13.02.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 13.02.2025, ditën e enjte, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 10/2022 (JR), datë 15.02.2022, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 479, datë 03.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Dosti.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në

Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik Florian Ballhysa, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, si dhe konkluzionet përfundimtare të paraqitura nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Altin Dumani, të cilët kërkuar përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 479, datë 03.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Dosti, shqyrtoi parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit dhe avokates së tij Romina Zano¹, të cilët kërkuar përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Arben Dosti (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport² të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- (iv) ka kryer deklarim të rremë;
- (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja, pasi kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dërgoi

¹ Avokatja e emëruar nga subjekti i rivlerësimit si përfaqësuese dhe mbrojtëse e tij, me anë të prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.12.2024.

² Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit Arben Dosti, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, është përcjellë në Komision nga ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.11.2018.

një raport³ pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

2.3. KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, duke dërguar pranë Komisionit një raport⁴ të hollësishëm, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga organet ndihmëse, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Komisioni, bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, bazuar në provat e administruara, si dhe në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, ka arritur në konkluzionet e mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

3.1. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë:

[...] Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij dhe personave të lidhur. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Arben Dosti, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

3.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës:

Subjekti i rivlerësimit Arben Dosti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

3.3. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

³ Raporti nr. {***} prot., datë 04.02.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. {***}, datë 18.03.2021.

⁴ Raporti për analizimin e aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit Arben Dosti, i KLGj-së, me nr. {***} prot., datë 23.10.2020.

[...] Në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

4. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, me vendimin nr. 479, datë 03.12.2021, Komisioni ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arben Dosti, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

5. Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”) ka paraqitur ankim⁵ kundër vendimit nr. 479, datë 03.12.2021, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Arben Dosti, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
6. Komisioneri Publik ka çmuar se vendimi i Komisionit është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioneri Publik, në ankim, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me:
 - (i) *rezultatet e hetimit mbi kontrollin e kriterit të pasurisë;*
 - (ii) *rezultatet e hetimit mbi kontrollin e kriterit të figurës; dhe*
 - (iii) *rezultatet e hetimit mbi vlerësimin e aftësive profesionale.*Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenet 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, ankimi i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 479, datë 3.12.2021, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.
7. Komisioneri Publik, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 2, nenin 61, pikat 2, 3, 4 dhe/ose 5 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar nga Kolegji që, pas marrjes në shqyrtim të shkaqeve të ankimit, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 479, datë 03.12.2021, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Dosti.
8. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë

9. Komisioneri Publik ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e parashikuar nga neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së

⁵ Ankimi i Komisionerit Publik me nr. {***} prot., datë 04.02.2022, në faqen zyrtare në internet të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në linkun: <https://ikp.al/wp-content/uploads/2022/02/60.Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-479-dat%C3%AB-3.12.2021-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%ABr-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-z.-Arben-Dosti.pdf>

cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë, pasi nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, për çështjet si vijojnë.

9.1. *Të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, të pretenduara me burim nga emigracioni, nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.*

9.2. *Vlera e të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, si të realizuara nga bashkëpunimi me shoqërinë “{***}” ShPK nuk provohet se janë realizuar nga një burim i ligjshëm dhe për të cilat janë paguar detyrimet përkatëse tatimore, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit.*

9.3. *Të ardhurat nga diferenca midis çmimit të shitjes të kontraktuar, me çmimin e blerjes të pretenduar, me burim nga shitja e njësisë së shërbimit në Kuçovë, nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme pasi nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.*

9.4. *Pasuritë e deklaruara në deklaratën e rivlerësimit, referuar rrethanave konkrete të faktit, i nënshtrohen kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklaramit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim apo ndonjë lloj kriteri përcaktues, sipas standardeve të vendosura nga legjislacioni i posaçëm dhe jurisprudenca tashmë e konsoliduar e Kolegjit.*

Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

- 10.** Komisioneri Publik ka pretenduar në ankim se informacionet e institucioneve verifikuese mundën eventualisht të rivlerësohen nga Kolegji, qoftë në rivlerësimin e kriterit të figurës dhe/ose në vlerësimin tërësor të procedurave, për të krijuar bindjen e plotë se subjekti i rivlerësimit nuk ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë apo ndodhet në kushtet e papërshtatshmërisë për të vazhduar detyrën.

Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

- 11.** Komisioneri Publik ka pretenduar në ankim se, referuar nenit 4, pika 2, nenit 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, duket se mangësitë e vërejtura në vlerësimin e aftësive profesionale janë të tilla që nuk justifikojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit duhet të konfirmohet në detyrë. Në mbështetje të këtij pretendimi, Komisioneri Publik ka parashtruar shkaqet e ankimit si vijojnë.

11.1. *Lidhur me denoncimin e znj. Y. Sh. (Xh.), të dhënat e rezultuara në rastin konkret, duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe/ose në vlerësimin tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 61, pika 5 e të njëjtit ligj.*

11.2. *Lidhur me denoncimin e shoqërisë “{***}” ShA, subjekti i rivlerësimit, në çështjen gjyqësore të denoncuar nga kjo shoqëri, ndodhej në kushtet dhe situatën e konfliktit të interesit, në raport me kërkesat e nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005, pika 1, shkronja “b”, “dh” dhe nënpika “v”,*

pasi nuk duhej të merrte pjesë në vendimmarrjen përkatëse, ku palë ndërgjyqëse ishte një shtetas me të cilin ka pasur një marrëdhënie preferenciale, juridiko-civile, apo angazhime të mëparshme miqësore.

11.3. Lidhur me çështjen penale me të pandehur shtetasin A. C., të dhënat e rezultuara në rastin konkret, duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe/ose në vlerësim tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 61, pika 5 e të njëjtit ligj.

11.4. Lidhur me informacionin e përftuar nga burime të hapura (mediat elektronike), që i referohet masës së sigurimit personal “Arrest shtëpie” për shtetasin P. N., të dhënat e rezultuara në rastin konkret, duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe/ose të trajtohen në vlerësimin tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 61, pika 5 e të njëjtit ligj.

11.5. Lidhur me raportin e vlerësimit profesional të hartuar nga KLGj-ja, të dhënat e rezultuara duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe/ose të trajtohen në vlerësimin tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 61, pika 5 e të njëjtit ligj.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

- 12.** Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) Legjitimimi i ankuesit

- 13.** Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit nr. 479, datë 03.12.2021, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

14. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 479, datë 03.12.2021, për subjektin e rivlerësimit Arben Dosti, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve, në datat 03.12.2024, 06.12.2024, 13.12.2024, 19.12.2024, 14.01.2025, 27.01.2025 dhe 13.02.2025.

14.1. Në seancën gjyqësore publike të datës 14.01.2025, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të institucionit të Komisionerit Publik, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

14.2. Në seancën gjyqësore publike të datës 13.12.2024, subjekti i rivlerësimit kërkoi pezullimin e gjykimit deri në verifikimin përfundimtar nga Kolegji të gjendjes së tij gjyqësore nëpërmjet depozitimit përpara çdo institucioni verifikues të gjurmëve papilare të gishtërinjve, si edhe mundësinë për të pritur një vendimmarrje të Gjykatës së Athinës në Greqi lidhur me procesin gjyqësor të iniciuar prej tij pranë kësaj gjykate ndaj Alpha Bank, në këtë shtet. Në të njëjtën seancë gjyqësore, subjekti i rivlerësimit i kërkoi Kolegjit edhe deklasifikimin e raportit të paraqitur nga DSIK-ja në lidhje me kontrollin e figurës. Me vendime të ndërmjetme, të marra në seancat gjyqësore të datave 13.12.2024 dhe 19.12.2024, trupi gjykues vendosi të rrëzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit lidhur me pezullimin e gjykimit të çështjes, si dhe kërkesat e tjera të paraqitura prej tij, si më poshtë.

(i) Urdhërimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK-ja) të kryejë deklasifikimin e raportit të figurës për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues e rrëzoi si një kërkesë të pabazuar në ligj. Referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, barra e provës, në kuadër të procesit të rivlerësimit, i përket subjektit dhe, për rrjedhojë, kërkesa për deklasifikimin e raportit të figurës duhet të ishte paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit pranë AKSIK-ut dhe ai nuk provoi përpjekjet e tij për ezaurimin e barrës së provës në këtë drejtim, për deklasifikimin e plotë të raportit të figurës.

(ii) Dhënien e kohës për paraqitjen e dokumenteve prej Alpha Bank të Greqisë, trupi gjykues e konsideroi si një kërkesë të pajustificuar, për shkak të kohës së mjaftueshme që kishte subjekti i rivlerësimit për marrjen e këtij dokumentacioni, që nga momenti i njohjes me shkaqet e ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik e deri në shqyrtimin e çështjes në Kolegji.

(iii) Marrjen e informacionit nga Ministria e Drejtësisë së Greqisë për gjendjen gjyqësore të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues e konsideroi si një kërkesë të ezauruar, për shkak se, siç analizohet më poshtë në këtë vendim, nga gjyqtarja relatore e çështjes në Kolegji, në fazën përgatitore të saj, ishin ndërmarrë veprime procedurale në këtë drejtim.

(iv) Verifikimin e gjendjes gjyqësore nëpërmjet krahasimit dhe verifikimit të gjurmëve papilare të subjektit të rivlerësimit, të depozituara në një nga format e përshkruara në kërkesën e tij, trupi

gjykues e konsideroi si një mjet prove të papërshtatshme për arritjen e një konkluzioni me ndikim në zgjidhjen e çështjes, sipas parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

14.3. Gjithashtu, trupi gjykues vendosi të njihet pranë agjencive ligjzbatuese me të njëjtin informacion, që është njohur edhe Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit. Në zbatim të kësaj vendimmarrjeje, më datë 09.01.2025, trupi gjykues verifikoi pranë institucionit të Shërbimit Informativ Shtetëror, informacionin me të cilin ishte njohur edhe Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe që ishte pjesë e raportit të DSIK-së mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit.

14.4. Në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, në vijim të hetimit gjyqësor të çështjes, vendosi të administrojë në cilësinë e provës, aktet shkresore të paraqitura në formën e duhur ligjore nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur parashtrimeve⁶, si dhe aktet shkresore të depozituara prej tij gjatë gjykimit në Kolegj⁷.

⁶ Subjekti i rivlerësimit paraqiti me parashtrimet e datës 27.11.2024, aktet si vijonë: i. prokurë e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.04.2022; ii. prokurë e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.10.2024; iii. vendim i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. {***} prot., datë 08.11.2024, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së shtetases znj. I. M.”; iv. shkresë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. {***} prot., datë 08.11.2024, me lëndë: “Njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesës pas verifikimit”, drejtuar për dijeni subjektit të rivlerësimit; v. vendim i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, “Për shpalljen e moskompetencës lëndore dhe kalimin e akteve”, datë 25.07.2022; vi. kërkesëpadi nr. {***} akti, datë 10.06.2016, e paditësit P. L., i përfaqësuar nga avokati A. D., përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; vii. vendim nr. {***}, datë 14.06.2016, i Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, për shqyrtim të kërkesës së gjyqtarit Arben Dosti për heqje dorë nga gjykimi i çështjes civile me palë paditëse z. P. L.; viii. kërkesë për marrje sigurimi, para Gjykatës së Shkallës së Parë njëanëtarëshe të Athinës, datë 12.11.2024, nga Arben Dosti, në gjuhën greke, përkthyer në gjuhën shqipe me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 27.11.2024, legalizuar me vulë apostile, përkthyer në gjuhën shqipe me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 27.11.2024; ix. kopje e dëshmisë së penalitetit për përdorim të përgjithshëm, nr. {***} prot., datë 13.11.2024, lëshuar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Greqisë, për z. Arben Dosti, e përkthyer në gjuhën shqipe.

⁷ Gjatë shqyrtimit gjyqësor, në seancat gjyqësore publike të zhvilluara në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet si vijojnë:

a) Në seancën gjyqësore të datës 13.12.2024: i. kërkesë për marrje sigurimi, para Gjykatës së Shkallës së Parë njëanëtarëshe të Athinës, datë 07.11.2024, nga Arben Dosti, në gjuhën greke, legalizuar me vulë apostile, përkthyer në gjuhën shqipe; ii. vendim nr. {***}, datë 10.05.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; iii. komunikim me postë elektronike, datë 03.12.2024, përkthyer në gjuhën shqipe me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 05.12.2024; iv. komunikim me postë elektronike, datë 26.12.2024, përkthyer në gjuhën shqipe me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 05.12.2024; v. komunikim regjistrimi në regjistrin e përgjithshëm tregtar të shoqërisë anonime me emrin Banka Tregtare e Greqisë SHA, i Ministrisë së Zhvillimit dhe Konkurrencës së Republikës së Greqisë, datë 28.06.2013, legalizuar me vulë apostile, përkthyer në gjuhën shqipe me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 05.12.2024; vi. kartelë personale e të dënuarit E. Xh., nr. i dosjes {***}, burgu Tepelenë; vii. raport vlerësimi i Shërbimit të Provës, Gjirokastër, për të dënuarin E. Xh.; viii. vendim nr. {***}, datë 27.12.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; ix. vendim, datë 05.10.2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, për pushimin e çështjes penale; x. vendim nr. {***}, datë 22.01.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; xi. kërkesëpadi nr. {***} akti, datë 10.06.2016, e paditësit P. L., i përfaqësuar nga

14.5. Pasi shqyrtoi dhe vlerësoi denoncimet e paraqitura në Kolegj, përpara⁸ dhe gjatë⁹ shqyrtimit gjyqësor të çështjes, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, të marrë në seancën gjyqësore të datës 19.12.2024, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe për tri çështje gjyqësore të adresuara nga denoncuesit, z. P. N., z. A. T. dhe z. A. R., duke e ftuar subjektin e rivlerësimit të mbante qëndrim lidhur me to dhe të paraqiste edhe aktet nga dosjet gjyqësore përkatëse.

avokati A. D., përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; xii. kërkesë e gjyqtarit Arben Dosti, datë 14.06.2016, për heqje dorë nga gjykimi i çështjes civile me nr. akti {***}, me palë paditëse z. P. L.; xiii. shkresë e Drejtorisë së Spitalit Rajonal Gjirokastrë me nr. {***} prot., datë 12.12.2024, me lëndë: “Kopje e kartelës klinike/ditore të njësuar me origjinalin për shtetasin Arben Dosti”.

b) Në seancat gjyqësore publike të datave 19.12.2024 dhe 14.01.2025: i. vendim nr. {***} akti, datë 09.05.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; ii. vendim nr. {***}, datë 05.06.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; iii. vendim nr. {***}, datë 01.03.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; iv. vendim nr. {***}, datë 11.10.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; v. vendim nr. {***} akti, datë 20.11.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; vi. vërtetim, datë 05.12.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë; vii. vërtetim nr. {***} prot., datë 17.12.2024, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; viii. vërtetim nr. {***} prot., datë 05.12.2024, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; ix. shkresë e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar nr. {***} prot., datë 18.12.2024, me lëndë: “Kthim përgjigje”, drejtuar z. Arben Dosti, bashkëlidhur së cilës gjendet kopje e shkresës së DSIK-së nr. {***} prot., datë 04.02.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Arben Dosti, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZh-së nr. {***}, datë 18.03.2021, drejtuar Komisionit; x. kopje e dëshmisë së penalitetit për përdorim të përgjithshëm, nr. {***} prot., datë 21.11.2024, lëshuar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Greqisë, për z. Arben Dosti, shoqëruar me vulë apostile, e përkthyer në gjuhën shqipe, me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 18.12.2024.

c) Akte të depozituara në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit me anë të kërkesës së regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 24.01.2025: i. printim nga sistemi E-Tax Shqipëri i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; ii. mandat bankar, datë 23.01.2025, i Credins Bank ShA; iii. urdhër pagese {***}, tatimi mbi të ardhurat individuale, për periudhën tatimore 24-A, 2024 janar-dhjetor; iv. Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave për periudhën tatimore 24-A, e znj. L. D..

⁸ Në Kolegj, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, janë regjistruar denoncimet si vijojnë: denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 13.01.2023 dhe nr. {***} prot., datë 16.01.2023, paraqitur nga znj. R. B.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 17.10.2024, paraqitur nga z. I. K.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 19.04.2022, paraqitur nga z. M. G.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 11.04.2019, paraqitur nga z. V. Ç.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 24.05.2023, paraqitur nga z. A. T.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 22.02.2022, paraqitur nga z. P. N.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 23.01.2020 dhe nr. {***} prot., datë 24.01.2020, paraqitur nga znj. Sh. H.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 30.09.2019, paraqitur nga z. A. Ç.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 15.11.2024, paraqitur nga z. A. R.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 21.11.2022, paraqitur nga znj. I. M.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 07.07.2022, paraqitur nga z. Gj. Ll.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 15.11.2024, paraqitur nga z. F. Xh. dhe z. Q. C..

⁹ Në Kolegj, gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, janë regjistruar denoncimet si vijojnë: denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 10.12.2024, paraqitur nga z. P. T.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 12.12.2024, paraqitur nga z. V. P.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 13.01.2025, paraqitur nga znj. R. B.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 17.01.2025, paraqitur nga z. T. Ç.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 04.02.2025, paraqitur nga z. F. Ç.; denoncim i regjistruar me nr. {***} prot., datë 17.01.2025, paraqitur nga z. E. A. dhe z. B. N..

14.6. Në seancat gjyqësore publike të datave 14.01.2025 dhe 27.01.2025, trupi gjykues vendosi: (i) të administrojë në cilësinë e provës aktet shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në mbështetje të shpjegimeve të tij mbi denoncimet e sipërcituara, të dhëna me parashtrimet e datës 09.01.2025¹⁰, dhe ato të depozituara në Kolegj më datë 24.01.2025¹¹; si dhe: (ii) të rrëzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen nga Kolegji të akteve të dosjeve gjyqësore që u përkasin tri çështjeve gjyqësore të adresuara nga denoncuesit, respektivisht pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatës së Lartë.

14.7. Në seancën gjyqësore publike të datës 27.01.2025, në konkluzionet përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke u qëndruar shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, kërkoi nga Kolegji ndryshimin e vendimit nr. 479, datë 03.12.2021, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Dosti. Subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare, i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi të vendimit nr. 479, datë 03.12.2021, të Komisionit.

15. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues analizoi shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik në ankim e në parashtrime, nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në konkluzionet përfundimtare dhe parashtrimet e konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, si dhe analizoi e vlerësoi provat e administruara gjatë hetimit administrativ në

¹⁰ a) Lidhur me çështjen gjyqësore të adresuar nga denoncimi i paraqitur nga z. P. N., subjekti i rivlerësimit paraqiti aktet: i. shkresë nr. {***} prot., datë 07.01.2025, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër; përmes së cilës përcillen kopje të procesverbaleve gjyqësore të çështjes penale me nr. {***}, datë regjistrimi 24.12.2020, dhe vendimi nr. {***}, datë 06.05.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; ii. kërkesë e subjektit të rivlerësimit, datë 26.12.2024, drejtuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me lëndë: “Marrje aktesh nga dosja gjyqësore”.

b) Lidhur me çështjen gjyqësore të adresuar nga denoncimi i paraqitur nga z. A. T., subjekti i rivlerësimit paraqiti aktet: i. vendim nr. {***}, datë 05.12.2022, i Gjykatës së Apelit Gjirokastër; ii. kërkesë e subjektit të rivlerësimit, datë 06.01.2025, drejtuar SPAK, për marrje informacioni mbi ecurinë procedurale të kallëzimit penal të vitit 2023 të z. A. T.; iii. kërkesë e subjektit të rivlerësimit, datë 07.01.2025, drejtuar ILD-së, lidhur me ecurinë e shqyrtimit të ankimit të paraqitur nga z. A. T.; iv. kërkesë e subjektit të rivlerësimit, datë 26.12.2024, drejtuar Gjykatës së Lartë, për marrjen e akteve gjyqësore të çështjes gjyqësore të përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 05.12.2022, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

c) Lidhur me çështjen gjyqësore të adresuar nga denoncimi i paraqitur nga z. A. R., subjekti i rivlerësimit paraqiti aktet: i. shkresë nr. {***} prot., datë 08.01.2025, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, drejtuar subjektit të rivlerësimit, bashkëlidhur së cilës gjendet vendimi nr. {***}, datë 29.05.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; ii. procesverbale të seancave gjyqësore të çështjes nr. {***} regj. them., të datave 29.02.2024, 16.04.2024 dhe 29.05.2024.

¹¹ Akte të depozituara në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit me anë të kërkesës së regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 24.01.2025, sa u përket denoncimeve: i. shkresë nr. {***} prot., datë 14.01.2025, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, me lëndë: “Dërgohet informacion”, drejtuar z. Arben Dosti; ii. vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 26.06.2023, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier; iii. shkresë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. {***} prot., datë 20.01.2025, me lëndë: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion me nr. {***} prot., datë 10.01.2025”, drejtuar z. Arben Dosti.

Komision dhe ato të administruara gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegj e që iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve, duke arsyetuar e konkluduar si vijon.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

16. Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara nga Komisioni, i është drejtuar juridiksionit kontrollues të Kolegjit duke ankimuar përfundimin e arritur nga Komisioni lidhur me përshkrimin dhe analizën e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, për të cilat ndan qëndrimin se nuk është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, si dhe me një vlerësim të drejtë të provave dhe jurisprudencës së Kolegjit, nisur nga fakti se të gjitha pasuritë e subjektit dhe të personave të lidhur me të¹² pretendohen se kanë të njëjtat burime të ardhurash.

16.1. Komisioneri Publik ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës dhe mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e deklaruara, e klasifikon atë në situatën e parashikuar nga neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë.

16.2. Komisioneri Publik, në përfundimin e mësipërm ka arritur pasi ka analizuar ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, me burim nga:

- (i) emigracioni;
 - (ii) bashkëpunimi me shoqërinë “{***}” ShPK;
 - (iii) shitja e njësisë së shërbimit në Kuçovë;
- duke parashtruar shkaqet e ankimit si vijojnë.

17. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit *ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, të pretenduara me burim nga emigracioni, nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës*, trupi gjykues konstatoi si vijon.

¹² Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Arben Dosti dhe personat e lidhur me të, në deklaratën e rivlerësimit, janë si vijojnë:

Apartament banimi me sip. (rreth) 80 m², në bashkëpronësi, privatizuar nga shteti në vitin 1992, në bazë të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, me vendndodhje Kuçovë. I pavlerësuar që nga koha e blerjes. Pjesa takuese 1/3.

Autoveturë, marka “Mercedes Benz”, blerë në vitin 2003, me të ardhura nga puna. Vlera 800.000 lekë. Pjesa takuese 100%.

Hua dhënë shtetasve I. dhe A. E., në shumën 100.000 euro, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.04.2014. Depozitë në emër të bashkëshortes së subjektit në Bankën Credins, me të ardhura nga puna e subjektit. Vlera 50.000 euro, pjesa takuese 100%.

Depozitë në emër të bashkëshortes së subjektit në bankën Societe Generale Albania, me të ardhura nga puna e subjektit. Vlera 45.000 euro, pjesa takuese 100%.

Depozitë në emër të nënës së subjektit në bankën Societe Generale Albania, vlera 4.000.000 lekë, pjesa takuese 100%.

17.1. Komisioni, në vendim¹³, ka arritur në konkluzionin: [...] rezulton e provuar se në prill të vitit 2000, familjarët e subjektit kanë disponuar shumën prej 38.000.000 dhrahmish, konvertuar me kursin e këmbimit të kohës, në vlerën prej rreth 15.200.000 lekë. Lidhur me këto vlera monetare, [...] trupi gjykues krijoi bindjen se ato kanë si burim kryesor të ardhurat e përfituara nga puna e subjektit të rivlerësimit në emigracion. Në këtë kuptim, duket i besueshëm dhe i vërtetë deklarimi i bërë nga subjekti mbi shumën e të ardhurave të përfituara nga puna në emigracion, të cilat janë referuar se kanë shërbyer si burim krijimi i pasurive të tij, në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në deklaratën “vetting”. [...] Në arsyetim logjik, bazuar në parimin e objektivitetit, trupi gjykues çmon se argumente të rëndësishme në këtë rast përbëjnë provueshmëria e ekzistencës së këtyre të ardhurave disa vite para fillimit të detyrës dhe shpjegimi bindës mbi ligjshmërinë e burimit të tyre nga puna në emigracion, në kuptim të mosekzistencës së asnjë dyshimi se ato mund të jenë krijuar nga ndonjë aktivitet i paligjshëm kriminal, por se janë të ardhura të cilat janë përfutur nga punë e ligjshme e kryer në mënyrë informale, kjo në pamundësi objektive për të qenë ndryshe, për shkaqe që nuk vareshin prej tij. Në këtë kontekst, vlerësohet edhe përpjekja e vazhdueshme e bërë nga subjekti për kërkimin e provave mbi ekzistencën e vlerave monetare të pretenduara si të disponuara prej tij në atë periudhë, në sistemin bankar të shtetit grek. [...] të ardhurat e deklaruara nga puna në emigracion, deklaruar me vërtetësi përgjatë gjithë këtij procesi, vlerësohet se duhet të konsiderohen si burime të ligjshme.

17.2. Në kundërshtim të këtij qëndrimi të Komisionit, Komisioneri Publik – në ankim e në parashtime gjatë gjykimit në Kolegj – dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme – në bisedimet përfundimtare – argumentuan se të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, të pretenduara me burim nga puna në emigracion, mbetën në nivel deklarativ për kohën, mënyrën dhe territorin ku janë krijuar, duke mos gjetur mbështetje në dokumentacion, i cili duhet të provojë: (i) ekzistencën e një burimi real të ardhurash të ligjshme; dhe (ii) vlerën reale të të ardhurave të krijuara nga personi deklarues dhe jo të mundësisë objektive për t'i realizuar këto të ardhura me punë, duke i ekuivalentuar me mundësinë potenciale për të krijuar të ardhura gjatë periudhës së pretenduar. Sipas Komisionerit Publik dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, jo gjithmonë remitancat mund të konsistojnë në dërgesa të vlerave monetare të krijuara nga burime të ligjshme dhe të konsiderohen si burime të ligjshme, në kuptim të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e Kushtetutës. Për rrjedhojë, të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, me burim nga emigracioni, nuk duhen konsideruar si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

17.3. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, mbajti të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, duke prapësuar se konkluzioni i Komisionerit Publik është i pabazuar në provat e paraqitura, si dhe në interpretim të drejtë të ligjit, në funksion të një procesi të rregullt ligjor. Sipas subjektit të rivlerësimit, për një periudhë disamujore, fundi i vitit 1999 deri në fillim të vitit 2000, nga persona të tretë janë derdhur në llogarinë e tij bankare në

¹³ Paragrafët 34.11-34.17 të vendimit të Komisionit.

Alpha Bank, afro 6-8 milionë dhrahmi, nga një punë ndërtimore që ai bashkë me një skuadër punëtorësh po kryenin në ishullin Rodos, në Greqi. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ka kontraktuar disa avokatë për gjetjen e llogarisë bankare dhe marrjen e informacionit, por deri tani nuk ka asnjë rezultat. Pasi ka konstatuar një përgjegjshmëri totale nga Alpha Bank në zgjidhjen e rastit, subjekti i rivlerësimit ka iniciuar edhe një proces gjyqësor në gjykatën e Athinës kundër këtij institucioni bankar. Në kushtet kur të ardhurat janë realizuar 30 vite përpara dhe pas përpjekjeve të vazhdueshme të subjektit të rivlerësimit për të siguruar dokumentacionin provues të tyre, Komisioneri Publik duhet të kishte mbajtur në konsideratë aplikimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe të përfshinte në analizë financiare të ardhurat e krijuara nga emigracioni. Në periudhën e realizimit të këtyre të ardhurave, në vitet 1992-2000, subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në asnjë pozicion shtetëror, si dhe nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor deklarimi apo pagimi detyrimi tatimor për to. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, për shkak të distancës së largët në kohë, e ka të pamundur të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat neto të kursyera prej tij, por që pa diskutim janë ato të deklaruara në deklaratën fillestare të para fillimit të detyrës, në shumën 14.000. 000 lekë.

18. Nga analizimi i akteve të administruara gjatë hetimit në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues konstatoi si vijon.

18.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar të ardhura nga emigracioni në shtetin grek, në periudhën 1992-2000, në shumën 35.000.000 dhrahmi, konvertuar në 14.000.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentin “Shpjegime lidhur me deklaratimet për pasuritë dhe burimet e krijimit të tyre”, në të cilin ka parashtruar rrethanat e krijimit të këtyre të ardhurave, shpjegime të përsëritura edhe gjatë hetimit të zhvilluar në Komision, si dhe gjatë gjykimit në Kolegj.

18.2. Në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga emigracioni (pa specifikuar vlerën e tyre) si një nga burimet e krijimit të pasurisë në formën e likuiditetit në *cash*, të depozituar në emër të bashkëshortes, në bankat e nivelit të dytë.

18.3. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit, për të provuar pretendimin e tij se ka punuar në Greqi dhe ka përfutur të ardhura, ka depozituar: (i) kopje të fletës së pasaportës, ku pasqyrohet viza njëvjeçare për kalimin në shtetin grek, për periudhën 08.04.1999 - 02.04.2000¹⁴; (ii) aktmarrëveshje për dhënie huaje, datë 18.05.2000, me palë huadhënëse znj. L. D. dhe palë huamarrëse z. A. C.. Referuar kësaj aktmarrëveshjeje, nëna e subjektit të rivlerësimit i ka dhënë hua pa interes z. A. C., shumën prej 20.000.000 dhrahmish (ose 8.000.000 lekë) për një afat kthimi deri në datën 31.12.2000; (iii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë

¹⁴ Vërtetuar njësisht me origjinalin me aktin noterial nr. {***} rep., datë 19.01.2021.

10.10.2000, me palë deklaruese z. Arben Dosti dhe z. P. K.¹⁵, në të cilën z. K. deklaroi se i ka kthyer subjektit të rivlerësimit shumën prej 18.000.000 dhrahmish (konvertuar në shumën prej rreth 7.200.000 lekë), deklaruar si të marrë hua prej babait të tij në muajin prill të vitit 2000; (iv) deklaratë noteriale e z. M. Gj., deklaratë noteriale e z. Sh. K. dhe deklaratë noteriale e z. K. M., të pajisura me vulë apostile dhe të përkthyer¹⁶. Deklaruesit shprehen se kanë punuar në shtetin grek së bashku me z. Arben Dosti, në sektorin e ndërtimit, duke marrë përsipër punë nga një arkitekt për të ndërtuar ndërtesa të reja, duke siguruar të ardhura të mira.

18.4. Gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, për të provuar përpjekjet e tij për të gjetur dokumentacionin bankar që vërtetonte një pjesë të të ardhurave të përfituara nga puna informale në shtetin grek, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion provues¹⁷ lidhur me kontraktimin prej tij të avokatëve që ushtrojnë profesionin në shtetin grek, si dhe të një studioje ligjore në Shqipëri, me qëllim mundësimin e marrjes së informacionit lidhur me ekzistencën e një llogarie bankare në Alpha Bank, në emrin e tij, në vitin 1999 ose 2000. Subjekti i rivlerësimit, për të provuar përpjekjet e vazhdueshme dhe pamundësinë për të provuar me dokumentacion ligjor të ardhurat *neto* të kursyera nga emigracioni në Greqi, edhe gjatë

¹⁵ Kopje e deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.10.2000, me palë deklaruese Arben Dosti dhe P. K. përpara noterit publik N. D., vërtetuar njësisht me origjinalin me vërtetimin nr. {***} rep., datë 10.02.2021, të noterit publik E. A..

¹⁶ Vërtetuar përkthimi me akt noterial me nr. {***} rep., datë 19.11.2021.

¹⁷ Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka paraqitur: (i) prokurë, datë 25.06.2020, në gjuhën greke, e përkthyer në gjuhën shqipe, me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 18.01.2021, me anë të së cilës subjekti autorizon avokatin Dh. Gr. K., anëtar i Dhomës së Avokatëve Athinë, që të paraqitet para çdo filiali të Alpha Bank dhe të kërkojë të informohet në lidhje me llogarinë bankare të subjektit të çelur në vitin 1999 ose 2000, në bankën Emporiki Trapeza, kjo e fundit e blerë nga Alpha Bank; (ii) prokurë e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.10.2018, me anë të së cilës subjekti emëron përfaqësues të posaçëm avokatin N. B., anëtar i Dhomës së Avokatëve Janinë, të cilit i jep të drejta dhe kompetenca të plota që të paraqitet në emër dhe për llogari të subjektit para Alpha Bank në Athinë, me qëllim depozitimin e kërkesës për pajisje dhe vërtetim dhe lëvizjet analitike të llogarisë që subjekti mban në këtë bankë; (iii) prokurë e përgjithshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.10.2021, me anë të së cilës subjekti autorizon studion ligjore “{***}” ShPK të kërkojë informacion në bankat e shtetit grek lidhur me llogari bankare të subjektit në çfarëdo periudhe; (iv) formular elektronik i Alpha Bank, datë 15.11.2021, së bashku me autorizimin e dhënë nga subjekti, avokatit të Athinës I. An. P., që në emër dhe për llogari të subjektit të paraqesë kërkesë tek Alpha Bank, në lidhje me llogarinë bankare të tij në këtë bankë për periudhën 1992-2000. Dokumentacioni është përkthyer dhe vërtetuar përkthimi me aktin noterial me nr. {***} rep., datë 19.11.2021; (v) prokurë e posaçme nr. {***} prot., nr. {***} kol., datë 21.04.2022, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka emëruar/aktuar si përfaqësues të posaçëm avokatin grek A. D., që të ndërmarrë të gjithë procedurën e nevojshme administrative apo gjyqësore, për marrjen e informacionit nga Alpha Bank ShA, lidhur me një llogari bankare në emër të tij në Bankën Emporiki në Greqi; (vi) komunikim elektronik i datës 22.11.2024, mes Alpha Bank ShA në Greqi dhe avokate A. K., sipas të cilit kësaj të fundit i komunikohet nga banka se kërkesa e paraqitur prej saj është marrë dhe po punohet për t’i kthyer përgjigje; (vii) komunikim elektronik i datës 26.11.2024, mes Alpha Bank ShA Greqi dhe avokates A. K.; (viii) komunikim nga Ministria e Zhvillimit dhe Konkurrencës i datës 28.06.2013, sipas të cilit komunikohet se në datën 28.06.2013, u miratua bashkimi i shoqërive aksionere “Alpha Bank ShA” me “Banka Tregtare Greke ShA”.

grykimit në Kolegj, paraqiti dokumentacion provues¹⁸ lidhur me një proces gryqësor të nisur në shtetin grek, me qëllim detyrimin e Alpha Bank ShA t'i jepte informacion lidhur me llogarinë bankare të pretenduar në emër të tij, si më sipër cituar.

19. Trupi grykues, në përfundim të shqyrtimit gryqësor, pasi u njoh me kërkimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë, me prapësimet dhe provat e paraqitura lidhur me to nga subjekti i rivlerësimit, analizoi sa vijon.

19.1. Aktet noteriale të cituara më sipër, për dhënie dhe kthim huaje, dëshmojnë vetëm faktin e ekzistencës së një shume likuiditetesh *cash* në vitin 2000, të cilën prindërit e subjektit të rivlerësimit e kanë dhënë hua në vlerat prej 20.000.000 dhrahmish dhe 18.000.000 dhrahmish, ndërsa nuk japin detaje për origjinën e krijimit të kësaj shume. Kopja e pasaportës së subjektit të rivlerësimit provon ligjshmërinë e hyrjes dhe qëndrimit të tij në Greqi për periudhën 1999-2000, por jo punësimin, kohëzgjatjen e tij, si dhe ligjshmërinë e të ardhurave të pretenduara nga punësimi i pretenduar në këtë shtet, në kuptim të pagesës së detyrimeve tatimore.

19.2. Trupi grykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues, me qëllim vërtetimin e punësimit të tij në shtetin grek apo të provojë vlerën e pagesave të përfituara dhe periudhën kohore gjatë së cilës janë përfituar ato. Sipas parashikimit të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës në procesin e rivlerësimit dhe ai nuk ka mundur të provojë me dokumentacion marrëdhënien e punës dhe as të ardhurat e përfituara e të pretenduara prej tij, për pasojë zbatimi i nenit 32, pika 2 e ligjit, për të provuar të gjitha elementet e një marrëdhënieje, nuk gjendet relevant. Lidhur me pamundësinë e subjektit të rivlerësimit për të siguruar të dhëna lidhur me llogarinë bankare të pretenduar të çelur në emër të tij, pranë Alpha Bank në Greqi, trupi grykues vëren se përpjekjet e subjektit të rivlerësimit për të gjetur dokumentacionin duhet të kishin filluar që në momentin që ai u bë zyrtar deklarues në ILDKPKI, pra në vitin 2013, në bazë të ligjit nr. 9049/2003, dhe jo vetëm në periudhën 2018 e në vijim për shkak të procesit të rivlerësimit. Pavarësisht kësaj, trupi grykues çmon të theksojë se edhe nëse do të provohet se subjekti i rivlerësimit kishte një llogari bankare në institucionet bankare greke, në të cilën kishte të ardhura të depozituara, përsëri do të duhej të provohet origjina ligjore e përfitimit të tyre, si dhe pagesa e detyrimeve tatimore, fakte këto që subjekti i rivlerësimit, siç ka pohuar

¹⁸ Gjatë grykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti: (i) kërkesë e datës 07.11.2024, "Për marrje mase sigurimi", e depozituar nga subjekti i rivlerësimit përmes avokates A. K. përpara Grykatës së Shkallës së Parë Njëanëtarëshe të Athinës, Greqi, kundër Alpha Bank ShA, me seli në Athinë, pasardhëse e Bankës Tregtare të Greqisë ShA, me objekt: "Të urdhërohet masa e sigurimit. Të detyrohet e paditura, si pasardhës universal i shoqërisë Banka Tregtare e Greqisë, të më japë informacion për llogarinë që kam mbajtur në bankën e lartpërmendur gjatë periudhës kohore 1999 – 2000, për arsyet e përmendura në historinë e kësaj kërkesë; (ii) raport i dorëzimit të kërkesës "Për marrje mase sigurimi", i lëshuar nga Grykata e Shkallës së Parë Athinë më datë 12.11.2024, sipas së cilës vërtetohet se: "Në grykatën e Shkallës së Parë të Athinës, sot më 12.11.2024, ditë e martë, ora 11:43, u paraqit në sekretari T. V. me nr. licence {***}, anëtare e Dhomës së Avokatisë Athinë, me numër tatimor {***}, dhe depozitoi shkresën gryqësore [...]. Caktohet si datë për diskutim 28.02.2025, ditë e premte, ora 9:00, në auditorin e Grykatës së Shkallës së Parë të Athinës [...]".

edhe vetë gjatë hetimit administrativ dhe gjatë gjykimit në Kolegj, nuk mund t'i provojë, pasi ka konfirmuar se nuk ka pasur leje qëndrimi dhe punësimi në shtetin grek, ka qenë informal. Në këto kushte, Kolegji çmon se shpjegimi i subjektit se gjendet në pamundësi për shkak të kohës së largët, që të disponojë dokumentacionin që provon të ardhurat e siguruar nga puna në ndërtim në ishullin Rodos në Greqi, nuk është një pretendim i drejtë dhe as një element i mjaftueshëm për të aplikuar nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që vetë përmbajtja e këtij neni parashikon zbatimin e kësaj dispozite për rrethana, si zhdukja e dokumentacionit, apo pamundësia për ta gjetur atë, rrethana që tregojnë se duhet të ketë të dhëna të mjaftueshme që dokumenti ka ekzistuar, por që nuk gjendet për shkaqe që nuk varen nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë jo vetëm ekzistencën dhe vlerën e të ardhurave të pretenduara prej tij, por nuk u provua edhe ligjshmëria e tyre në drejtim të pagesës së detyrimeve tatimore në shtetin e origjinës, sipas parashikimeve të përcaktuara në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së së vitit 2016, si dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit në çështje të trajtuara, ndër vite, për të ardhurat e pretenduara me prejardhje nga emigracioni.

19.3. Në këto kushte, në ndryshim nga Komisioni, trupi gjykues çmoi se të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga subjekti i rivlerësimit nga puna në ndërtim në emigracion, edhe pse janë të deklaruara në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës dhe në atë të rivlerësimit, mbeten të ardhura të paprovuara, në nivel deklarativ, pasi subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë me dokumentacion provues marrëdhënien e punës, ekzistencën dhe vlerën e të ardhurave të pretenduara prej tij, kohën e krijimit të tyre, si dhe ligjshmërinë e tyre në drejtim të pagesës së detyrimeve tatimore në shtetin e origjinës, sipas parashikimeve të përcaktuara në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit në çështje të trajtuara ndër vite.

19.4. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i Komisionerit Publik se të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, me burim nga emigracioni, nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, është një pretendim i bazuar në prova dhe në ligj, për pasojë këto të ardhura të pretenduara nuk mund të llogariten në burimet e ligjshme të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për pasurinë “likuiditet”, të pretenduar si të krijuar me këto të ardhura, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

20. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, të ardhurat e deklaruara si të realizuara nga bashkëpunimi me shoqërinë “{***}” ShPK nuk provohet se janë realizuar nga një burim i ligjshëm dhe për të cilat të jenë paguar detyrimet përkatëse tatimore, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit*, trupi gjykues analizoi si më poshtë.

20.1. Komisioni, në vendim¹⁹, ka arritur në konkluzionin: [...] Parë në një këndvështrim tjetër, në kushtet kur Komisioni krijoi bindjen mbi punën e kryer/bashkëpunimin e subjektit me shoqërinë “{***}” ShPK, në rastin e kategorizimit të saj si një marrëdhënie shërbimi e kryer nga subjekti për shoqërinë, në vlerësim të ligjshmërisë së burimit të krijimit të këtyre të ardhurave të pretenduara, u analizua kuadri ligjor mbi bazën e së cilit do të duhej të deklaroheshin, mbaheshin dhe paguheshin detyrimet tatimore mbi to. Komisioni vëren se ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, është ligji bazë mbi të cilin rregullohen marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat [...] Pra, duke e analizuar këtë marrëdhënie nën prizmin e një shërbimi të kryer nga subjekti si individ, detyrimi për deklarimin, mbajtjen dhe pagesën e tatimit mbi këto të ardhura i takonte shoqërisë “{***}” ShPK, e cila në këtë rast do të luante rolin e agjentit tatimor. Gjithsesi, Komisioni vlen të theksojë faktin se që në deklarimin fillestar (deklarata para fillimit të detyrës, dorëzuar në datën 13.01.2014 në ILDKPKI), si edhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna në datën 19.09.2014, drejtuar ILDKPKI-së, subjekti ka referuar si burim krijimi të pasurive, të ardhurat nga puna/si sipërmarrës/nga bashkëpunimi në biznes me shoqërinë “{***}” ShPK, të ardhura të cilat deklarohen se janë krijuar për periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2010, pra, para fillimit të detyrës. [...] Komisioni arrin në përfundimin se për pasuritë të cilat janë konstatuar si të krijuara para fillimit të detyrës, të deklaruara edhe në deklaratën e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm ligjshmërinë e të ardhurave të referuara si burim krijimi i tyre.

20.2. Në kundërshtim të këtij qëndrimi të Komisionit, Komisioneri Publik – në ankim e në parashtime gjatë gjykimit në Kolegj – dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme - në bisedimet përfundimtare – argumentuan se të ardhurat e deklaruara, me burim të pretenduar punësimin/marrëdhënien e interesit në shoqërinë “{***}” ShPK, mbetën në nivel deklarativ, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor burimin e krijimit të këtyre të ardhurave, as në formën e një marrëdhënieje punësimi me këtë shoqëri dhe as në formën e një marrëdhënieje kontraktuale të një lloji tjetër. Komisioneri Publik dhe, më tej, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kanë vlerësuar se të ardhurat e deklaruara si të realizuara nga bashkëpunimi me shoqërinë “{***}” ShPK nuk provohet se janë realizuar nga një burim i ligjshëm dhe për to të jenë paguar detyrimet përkatëse tatimore, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit.

20.3. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, mbajti të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, duke pretenduar se shoqëria “{***}” ShPK ka pasur dhe ka si ortak të vetëm, njëkohësisht dhe administrator, z. A. C., një mik i tij i hershëm. Për shkak të punëve që kishte dhe në mungesë të likuiditeteve, subjekti i rivlerësimit i ka ofruar shumën 20 milionë dhrahmi ose 8.000.000 lekë. Bashkëpunimi i tyre ka qenë miqësor dhe i padokumentuar në aktin e themelimit apo në statutin e shoqërisë. Detyrimet e subjektit të

¹⁹ Paragrafët 34.18 - 34.39 të vendimit të Komisionit.

rivlerësimit në shoqëri fillonin që nga momenti i përpilimit të dokumenteve të tenderave, përfaqësimin e shoqërisë në tendera, ndjekjen e punimeve dhe gjithçka tjetër që nevojitej, deri në përfundimin e plotë të punimeve. Nga momenti i fillimit të bashkëpunimit, tremujori i fundit i vitit 2000, deri në periudhën e verës së vitit 2002, përfshirja e subjektit të rivlerësimit në veprimtarinë e shoqërisë ka qenë me kohë të plotë, ashtu siç shënohet edhe në librezën e punës, si periudhë punësimi në këtë shoqëri, periudha 01.01.2001 deri më 31.05.2002. Në shtator - tetor 2002, subjekti i rivlerësimit ka filluar studimet e larta me shkëputje nga puna dhe, për këtë arsye, veprimtaria e tij në shoqëri ka qenë më e kufizuar. Pas mbarimit të studimeve, pas vitit 2006, për shkak edhe të disa angazhimeve publike në qytetin e Kuçovës, bashkëpunimi me shoqërinë ka ardhur duke u reduktuar, derisa në vitin 2010 është mbyllur përfundimisht. Siç ka deklaruar edhe në ILDKPKI në datën 19.09.2014 dhe në shpjegimet e dhëna në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, shuma që ka përfituar për gjithë këtë periudhë nga bashkëpunimi me shoqërinë në fjalë, është rreth 8.000.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nuk është paguar me pagë fikse, por ka marrë shpërblim në përqindje, i cili llogaritej pas përfundimit të çdo pune publike dhe shumica e transaksioneve kanë qenë në *cash*, dorazi. E vetmja pagesë që është kryer me bankë është kryer në vitin 2001 ose në fillim të vitit 2002, kur subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria e shoqërisë shumën prej afro 4-6 milionë lekë, tërheqje e kryer me çek të lëshuar nga shoqëria, por që subjekti i rivlerësimit e ka të pamundur ta dokumentojë. Pas kërtimeve të shumta, ai ka arritur të gjejë llogarinë në emër të tij në Bankën e Kursimeve, ku tregohet se në datën 11.03.2002, ka çelur llogari në këtë bankë, fillimisht në shumën 1.400.000 lekë dhe në datën 14.03.2002, llogaria kishte balancën 4.000.000 lekë, të cilat ishin paratë e fituara nga bashkëpunimi në këtë periudhë me shoqërinë “{***}” ShPK. Kontributin e tij të investuar, subjekti i rivlerësimit e ka marrë në fund vitin 2005, fillim vitin 2006. Këto para, më pas, ia ka huazuar mikut të tij, z. I. E., i cili më datë 24.06.2005, ka themeluar shoqërinë “{***}” ShA, në të cilën zotëronte 49% të kuotave dhe kishte nevojë për likuiditete. Që prej asaj periudhe, një pjesë e konsiderueshme e parave të subjektit të rivlerësimit janë përdorur për funksionimin e kësaj shoqërie. Të gjitha këto të ardhura janë deklaruar saktësisht prej tij në deklaratën e rivlerësimit dhe në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës. Lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore për shumatat e përfituara nga bashkëpunimi me shoqërinë në fjalë, subjekti i rivlerësimit pretendoi se këtë detyrim nuk e ka pasur ai, por shoqëria, pasi marrëdhënia e tyre ka pasur tiparet e një partneriteti/punësimi, pasi ai kryente punën për llogari të kësaj shoqërie tregtare. Referuar legjislacionit fiskal, përgjegjësia për përlllogaritjen, mbajtjen dhe pagimin e taksave/tatimeve bie mbi punëdhënësin dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë mundësi për të paguar vetë detyrimin tatimor. Po ashtu, në vitin 2003, shoqëria nuk ka pasur detyrimin që pagesat t’i kryente përmes sistemit bankar.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se arsyetimi i Komisionerit Publik për mosnjohjen e këtyre të ardhurave, nuk qëndron drejt në raport me faktet e hetuara, për rrjedhojë Komisioni, me të drejtë, i ka konsideruar ato si të ardhura të ligjshme, në përputhje me kërkesa e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

21. Nga analizimi i akteve të administruara gjatë hetimit në Komision, trupi gjykues konstatoi si vijon.

21.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar të ardhura nga punësimi në shoqërinë “{***}” ShPK në formën e partneritetit, për periudhën shtator 2000 deri në vitin 2010, në shumën 8.000.000 lekë deri në 10.000.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës, subjekti ka paraqitur dokumentin “Shpjegime lidhur me deklaratimet për pasuritë dhe burimet e krijimit të tyre”, në të cilin ka parashtruar marrëdhënien e tij me shoqërinë “{***}” ShPK.

21.2. Në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit, të ardhurat nga sipërmarrja, pa specifikuar vlerën e tyre dhe pa identifikuar sipërmarrjen, i ka deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë në formën e likuiditetit në *cash*, të depozituar në bankat e nivelit të dytë.

21.3. Për të provuar deklaratimet e tij lidhur me të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga puna/bashkëpunimi në biznes me shoqërinë “{***}” ShPK, si dhe marrëdhënien me këtë shoqëri, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision:

(i) aktmarrëveshje për dhënie huaje nr. {***} rep., datë 18.05.2000, me palë huadhënëse, znj. L. D., dhe palë huamarrëse, z. A. C., për dhënie huaje pa interes, në shumën prej 20.000.000 dhrahmi (ose 8.000.000 lekë), me afat kthimi deri në datën 31.12.2000; (ii) kopje të librezës së punës²⁰, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka qenë i regjistruar si punëtor i shoqërisë “{***}” ShPK, në periudhën 01.01.2001 - 31.05.2002; (iii) shkresë të datës 22.01.2021, të noteres publike A. B., e cila konfirmon se në regjistrin e përgjithshëm të akteve dhe veprimeve noteriale, në faqen me nr. 40, është regjistruar akti noterial “Kontratë huapërdorje automjeti”²¹, me palë: huadhënësi A. C. dhe huapërdorësi Arben Dosti; (iv) vërtetim pa datë, me vulën e shoqërisë, nënshkruar nga ortaku i vetëm dhe administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, z. A. C., i cili ka pohuar se subjekti i rivlerësimit, për periudhën kohore 2000-2010, ka kontribuar në funksionimin e kësaj shoqërie – në vitin 2001 ka kontribuar duke financuar një shumë rreth 8.000.000 lekë, shumë e cila i është kthyer në vitin 2006. Falë punës si investues, përfaqësues i shoqërisë në tenderime, si dhe konsulencës juridike është shpërblyer me shumën rreth 8.000.000 lekë - 10.000.000 lekë, shlyer periodikisht pas përfundimit të punëve që kryente shoqëria. Pas vitit 2002, falë miqësisë, marrëveshja ka qenë e paformalizuar, duke funksionuar normalisht deri në përfundim të saj, në vitin 2010; (v) vërtetim nr. {***} prot., datë 08.06.2018, lëshuar nga Banka Raiffeisen, dega Gjirokastër, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka qenë klient i Bankës së Kursimeve, dega Kuçovë, me depozitë kursimi çelur në datë 11.03.2002, në shumën 1.400.000 lekë. Gjendja e llogarisë më datë 14.03.2002, ka qenë 4.000.000 lekë. Gjendja e depozitës, në datën e mbylljes, 29.04.2003, ka qenë në shumën 2.079.706 lekë; (vi) kontratë shitje kuotash me kusht²², me palë shitëse z. I. E. dhe palë blerëse z. Arben Dosti, sipas së cilës pala shitëse i shet palës blerëse 20% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “{***}” ShPK, në shumën 250.000 euro, nga të cilat 200.000 euro janë

²⁰ Vërtetuar njësia me origjinalin me vërtetimin nr. {***} rep., datë 19.01.2021.

²¹ Kontratë huapërdorje automjeti, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.07.2000.

²² Kontratë shitjeje kuotash me kusht nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.04.2008.

paguar nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale dhe shuma prej 50.000 eurosh do të paguhej brenda një viti nga data e lidhjes së kësaj kontrate. Pala blerëse do ta regjistronte këtë kontratë me dhënien e miratimit nga ortakut tjetër i shoqërisë.

21.4. Trupi gjykues konstatoi se nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

(i) Në përgjigje të kërkesës së drejtuar nga ILDKPKI-ja, administratori dhe ortakut i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK ka konfirmuar marrëdhënien e tij me subjektin e rivlerësimit, duke përshtatur të njëjtin rrjedhë të ngjarjes si subjekti i rivlerësimit. Në total, shuma që ka përfituar Z. Dosti nga bashkëpunimi me shoqërinë, ka qenë në masën 8.000.000 - 10.000.000 lekë. Z. Dosti ka kontribuar financiarisht në shoqëri, sidomos në vitin e parë të bashkëpunimit, për shkak të aktivitetit të shtuar të shoqërisë, nevojës së saj si për likuiditete, ashtu edhe për bazë materiale dhe mjete pune. Kontributi ka qenë afro 8.000.000 lekë, i likuiduar në dy këste deri në vitin 2006. Shoqëria nuk disponon dokumentacion vërtetues të këtyre fakteve.

(ii) ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Berat, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.01.2021, ka informuar Komisionin se për periudhën janar 2001 - maj 2002, subjekti i rivlerësimit ka qenë i regjistruar si i punësuar në shoqërinë “{***}” SHPK, duke dhënë informacion edhe për pagat bruto dhe kontributet e paguara përkatëse.

(iii) Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, me shkresën nr. {***} prot., datë 25.01.2021, ka informuar Komisionin lidhur me të ardhurat e realizuara, fitimet e deklaruara, si dhe fitimin neto të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi “{***}” ShPK, sipas balanceve dhe deklarave të tatimit mbi fitimin në sistemin informatik C@TS, për periudhën 1996-2006, 2008-2010 dhe për vitin 2016.

22. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues vëren se në kontekstin e procesit të rivlerësimit, deklarimi i saktë dhe i plotë i burimit financiar të krijimit të pasurisë dhe të ardhurave, si dhe ligjshmëria e këtij burimi janë kushte thelbësore për të kaluar testin e kriterit të vlerësimit të pasurisë. Në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, sipas jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, në mënyrë që pasuria në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të të konsiderohet e ligjshme, duhet që njëkohësisht të jetë bazuar në një veprim të ligjshëm juridik, por edhe të jetë paguar detyrimi tatimor ose të jetë në kushtet e përjashtimit ligjor nga detyrimi tatimor.

22.1. Duke përdorur këtë jurisprudencë si referencë në analizimin e shkakut të ankimit, pasi shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik dhe ato të Drejtuesit të Prokurorisë, si dhe shpjegimet e prapësimet e subjektit të rivlerësimit për to, trupi gjykues, në ndryshim nga sa ka arsyetuar dhe konkluduar Komisioni në vendim, vlerësoi se të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si të realizuara nga bashkëpunimi me shoqërinë “{***}” ShPK, nuk provohet se janë realizuar nga një burim i ligjshëm, pasi pavarësisht pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe administratorit/ortakut të vetëm të shoqërisë “{***}” ShPK për partneritet dhe bashkëpunim mes tyre, nga dokumentacioni i dorëzuar prej vetë subjektit, rezulton se marrëdhënia mes tyre e dokumentuar, është përqendruar në dy momente: (i) në marrëdhënien e huasë mes Z. A. C. dhe nënës së subjektit të rivlerësimit në vitin 2000, në shumën rreth 8.000.000 lekë; (ii) në

marrëdhënien e punësimit të subjektit të rivlerësimit në këtë shoqëri, në periudhën 01.01.2001 - 31.05.2002, vërtetuar nga të dhënat e pasqyruara në librezën e punës së subjektit, si dhe të dhënat e përcjella nga ISSh-ja për pagat bruto dhe pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore të derdhura nga shoqëria për këtë periudhë.

22.1.1. Sa i takon marrëdhënies së huasë²³, referuar aktmarrëveshjes së sipërcituar, ajo jo vetëm është e lidhur me afat kthimi deri më 31.12.2000, por edhe është e lidhur mes dy individëve, nënës së subjektit të rivlerësimit dhe z. A. C., në cilësinë e individit dhe jo në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë “{***}” ShPK. Huaja është dhënë në *cash*, duke mos pasur një dokumentacion financiar që të provojë ekzistencën e shumës dhe kalimin e saj te huamarrësi. Edhe nga verifikimi i bilancit të shoqërisë për vitin 2000, të dorëzuar në organet tatimore dhe përcjellë në Komision nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, rezulton se në zërin “Detyrime”, nuk është pasqyruar asnjë hua e mundshme e marrë prej shoqërisë apo qoftë edhe prej ortakut të vetëm të saj nga të tretët. Referuar bilanceve, kjo situatë paraqitet për të gjithë periudhën 2000-2006, periudhë në të cilën pretendohet se është marrë dhe shlyer huaja në shumën prej 8.000.000 lekësh, sipas aktmarrëveshjes me nr. {***} rep., datë 18.05.2000. Edhe për sa i përket pretendimit të kthimit të kësaj huaje nga shoqëria, rezulton se fitimi *neto* i realizuar prej saj, i deklaruar në organet tatimore dhe i vlefshëm për t’u konsideruar për efekt të këtij procesi, për periudhën 2000-2006, ka qenë në shumën totale prej 6.566.467 lekësh, pra një shumë më e vogël se sa huaja e pretenduar e shlyer në masën 8.000.000 lekë. Në këto kushte, trupi gjykues konstatoi se sa më sipër, dëshmon për një marrëdhënie huaje në *cash*, pa interes, mes individëve, e cila pretendohet të jetë shlyer tërësisht, por që nuk evidenton asnjë indicie e cila të provojë se mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK të ketë ekzistuar një marrëdhënie bashkëpunimi apo partneriteti.

22.1.2. Për sa i përket marrëdhënies së punësimit të subjektit të rivlerësimit pranë së njëjtës shoqëri, e pretenduar se ka qenë një marrëdhënie aktive për periudhën 2000-2010, trupi gjykues konstatoi se përveç harkut kohor 01.01.2001 - 31.05.2002, gjatë të cilit subjekti i rivlerësimit ka qenë i deklaruar në organet tatimore si i punësuar pranë kësaj shoqërie dhe ka përfutur si pagë shumën totale prej 138.994 lekësh, në periudhën në vijim, deri në vitin 2010, nuk gjendet asnjë indicie që të orientojë drejt një punësimi të mundshëm, në çdo lloj forme (konsulencë etj.) të subjektit të rivlerësimit në këtë shoqëri. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kontrata e huapërdorjes së automjetit, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.07.2000, me palë: huadhënës A. C. dhe huapërdorës Arben Dosti, provon marrëdhënien e punësimit të subjektit në shoqërinë “{***}” ShPK, nuk gjendet i bazuar në përmbajtjen e kësaj kontrate, e cila është lidhur mes dy individëve dhe në të nuk evidentohet ndonjë qëllim i posaçëm i përdorimit të këtij automjeti nga huapërdoruesi, për nevoja të aktivitetit të shoqërisë, në të cilën huadhënësi ishte administrator dhe ortak i vetëm.

²³ Duke abstraguar nga konkluzioni i arritur më sipër në këtë vendim, se të ardhurat e deklaruara nga subjekti, të pretenduara me burim nga emigracioni, të cilat kanë shërbyer si burim financiar për dhënien e huasë në fjalë, nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme.

22.1.3. Deklarimet e z. A. C. dhe ato të subjektit të rivlerësimit, se ky i fundit, pas vitit 2002, nuk është paguar me pagë, por ka përfituar pjesë të konsiderueshme nga fitimi i shoqërisë, nuk gjejnë mbështetje në dokumentacionin e kësaj shoqërie, përcjellë në Komision nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat²⁴. Këto deklarime, të cilat synojnë të legjitimojnë shpërndarjen e fitimit të shoqërisë të një individ i cili nuk figuron si mbajtës i kuotave të shoqërisë, nuk përputhen jo vetëm me parashikimet ligjore, por as me logjikën ekonomike e financiare të krijimit dhe funksionimit të një shoqërie tregtare. Edhe lëvizjet në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit në Bankën e Kursimeve, dega Berat, vërtetojnë se në vitin 2002, ai ka pasur një depozitë në shumën 4.000.000 lekë, por nuk japin asnjë të dhënë nëse kjo shumë rrjedh nga marrëdhënia e bashkëpunimit me shoqërinë në fjalë, për shkak të shërbimeve të ofruara prej subjektit të rivlerësimit për këtë shoqëri. Të njëjtin qëndrim trupi gjykues mbajti edhe për sa i përket dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit në Komision, lidhur me procedurat e tenderimeve publike në të cilat ka marrë pjesë shoqëria “{***}” ShPK, i cili provon veprimtarinë e kësaj të fundit në përmbushje të objektit të aktivitetit të saj tregtar, por që nuk dëshmon, në këtë kuadër, kontributin apo shërbimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit kundrejt shoqërisë.

22.2. Lidhur me verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të pretenduara në drejtim të pagimit të detyrimeve tatimore për to, nga tërësia e rrethanave faktike të analizuara më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i deklaruar/regjistruar si i punësuar pranë shoqërisë për periudhën 2002-2010 dhe as si ortak i saj²⁵. Përgjatë gjithë hetimit administrativ dhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se marrëdhënia e tij e partneritetit me shoqërinë “{***}” ShPK bazohej në një bashkëpunim miqësor dhe, si e tillë, ka qenë një marrëdhënie e padokumentuar në aktin e themelimit apo në statutin e shoqërisë. Sipas tij, ky qëndrim është konfirmuar edhe nga administratori i shoqërisë, z. A. C., në vërtetimet e lëshuara prej tij për efekt të këtij procesi. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se mungesa e dokumentimit të partneritetit/bashkëpunimit të pretenduar është një fakt determinues për rrëzimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se për pagesat e pretenduara se janë kryer nga shoqëria kundrejt tij, detyrimi për deklarimin, mbajtjen dhe pagimin e tatimit përkatës i përkiste shoqërisë, pasi në logjikën e legjislacionit tatimor, nuk mund të paguhen detyrime tatimore për një individ me të cilin shoqëria tregtare nuk ka formalizuar asnjë lloj marrëdhënieje nga ato që përfshihen në objektin e rregullimit të legjislacionit për tatimin mbi të ardhurat.

²⁴ Informacion i përcjellë në Komision nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat me shkresën nr. {***} prot., datë 25.01.2021.

²⁵ Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti nën përgjegjësi, për efekt të plotësimit të deklaratave në kuadër të procesit të rivlerësimit, rezulton se në periudhën 2002-2006, ai ka ndjekur studimet e larta, me shkëputje nga puna, në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Shkodrës, ndërsa shoqëria “{***}” ShPK e ushtronte aktivitetin e saj në Kuçovë, Berat; në periudhën janar 2007 - dhjetor 2008, subjekti ka ushtruar detyrën e juristit në bashkinë Perondi, Kuçovë; në periudhën qershor 2008 - shtator 2011, subjekti është regjistruar si person fizik për ushtrimin e veprimtarisë si avokat.

22.3. Në përfundim të analizës si më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pretendimi i Komisionerit Publik dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, se ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, vlera e të ardhurave të deklaruara si të realizuara nga bashkëpunimi me shoqërinë “{***}” ShPK prej 8.000.000 - 10.000.000 lekësh, nuk provohet se është realizuar nga një burim i ligjshëm dhe për të cilën të jenë paguar detyrimet përkatëse tatimore, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit, është një pretendim i bazuar në prova dhe në ligj e, për pasojë, këto të ardhura të pretenduara nuk mund të llogariten në burimet e ligjshme të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për pasurinë “likuiditet në *cash*”, depozituar në bankat e nivelit të dytë, të krijuar me këto të ardhura, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

23. Lidhur me shkakun e ankimit sipas të cilit, *ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, të ardhurat nga diferenca midis çmimit të shitjes të kontraktuar me çmimin e blerjes të pretenduar, me burim nga shitja e njësisë së shërbimit në Kuçovë, nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme pasi nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës*, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

23.1. Komisioni, në vendim²⁶, ka konkluduar se: “[...] në vlerësim të provave të administruara dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues krijoi bindjen se njësia e shërbimit është shitur realisht më shumë se vlera e përcaktuar në kontratë, por se gjithsesi rezulton se nuk janë paguar plotësisht detyrimet tatimore për çmimin e pretenduar. Trupi gjykues çmon se, në këtë rast, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi subjekti i rivlerësimit, qoftë edhe të karakterit etik, vlerësuar kjo për kohën kur është kryer transaksioni, si edhe për faktin se titullare e pasurisë ka qenë vetëm nëna e tij, e cila ka pasur të drejta dhe detyrime të plota në këtë marrëdhënie juridike. Nga ana tjetër, Komisioni vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit se ka përfutur një pjesë të vlerës së përfutur nga shitja e kësaj pasurie, fakt ky i pranuar nga nëna e tij, me argumentin se kjo ka ndodhur për shkak të pagesës së çmimit të privatizimit dhe investimeve të kryera te kjo pasuri nga subjekti, ku përfshihen edhe shtesat funksionale të kësaj pasurie, të pasqyruara në vetëdeklarimin për legalizimin e shtesës së datës 30.10.2006”.

23.2. Në kundërshtim të këtij qëndrimi të Komisionit, Komisioneri Publik – në ankim e në parashtrime gjatë gjykimit në Kolegj – dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme – në bisedimet përfundimtare – argumentuan se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në mungesë të provave dokumentare, mbeten të një natyre deklarative dhe vijnë në kontradiktë me përmbajtjen e një akti me vlerë të plotë ligjore, siç është kontrata e shitblerjes së pasurisë të paluajtshme. Në kushtet kur, nga aktet e administruara gjatë hetimit të Komisionit, nuk u provua shitja e njësisë së shërbimit në vlerën 12.800.000 lekë, si dhe as pagesa e detyrimit tatimor për vlerën e pretenduar, diferenca midis çmimit të shitjes, të kontraktuar në vlerën 3.900.000 lekë, me çmimin e blerjes, të pretenduar

²⁶ Paragrafët 34.33 - 34.39 të vendimit të Komisionit.

prej 12.800.000 lekësh, nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme, bazuar dhe në jurisprudencën përkatëse të Kolegjit.

23.3. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në prapësim të shkakut të ankimit, mbajti të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit në Komision, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se pretendimet e Komisionerit Publik, lidhur me të ardhurat e përfituara prej tij nga shitja e njësisë së shërbimit në Kuçovë, janë të pambështetura në provat dhe shpjegimet e dhëna nga ai gjatë procesit të rivlerësimit. Pasuria “njësi shërbimi”, në Kuçovë, ka qenë në pronësi të nënës së tij, e privatizuar prej saj në vitin 1991, si punonjëse e Ndërmarrjes së Tregtisë, Kuçovë. Vlera e privatizimit të njësisë ka qenë rreth 20.000 - 30.000 lekë, e paguar në vitin 1992 ose 1993, prej parave të dërguara prej subjektit të rivlerësimit, i cili në atë kohë ishte emigrant në shtetin e Greqisë. Në vitet 1997-1998, njësisë i janë bërë disa shtesa dhe sipërfaqja është dyfishuar dhe shpenzimet përsëri janë paguar nga paratë e dërguara prej tij, nga Greqia. Në vitin 2000, kur subjekti është kthyer nga Greqia, ka kryer rikonstrukcionin e njësisë, që më pas është shitur në shumën 12.800.000 lekë. Nga këto, shuma prej 12.000.000 lekësh është ndarë mes subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij. Kjo ndarje është dakordësuar për shkak të investimeve të vazhdueshme që ishin bërë në njësi nga të ardhurat që subjekti dispononte dhe që i kishin rritur shumë vlerën objektit. Njësia është shitur nga nëna e subjektit të rivlerësimit në shumën 12.800.000 lekë, e paguar në dy kështe nga blerësi. Kësti i parë në shumën 8.000.000 lekë është marrë rreth një muaj përpara lidhjes së kontratës së shitjes dhe është depozituar në bankë, ndërsa kësti i dytë është marrë në momentin e shitjes. Shumat e përfituara nga shitja e njësisë janë depozituar në bankë, në muajin dhjetor 2004 janë depozituar 8.000.000 lekë dhe në muajin janar 2005 duket shtimi i të hollave në bankë në shumën 10.000.000 lekë. Likuiditetet që nëna e subjektit të rivlerësimit ka në llogari bankare, janë pikërisht pjesa që ajo ka mbajtur nga shitja e njësisë. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk ka qenë asnjëherë pronar apo bashkëpronar i sendit, as e ka shfrytëzuar dhe sendi nuk është shitur prej tij, por nëna e tij i ka dhënë shumën prej 6.000.000 lekësh, që konsiderohet si kthim i të hollave të kontribuara prej tij për blerjen e njësisë dhe për çdo investim të bërë në të. Në momentin e shitjes së njësisë, subjekti ka qenë student dhe nuk ishte në marrëdhënie punësimi që të dyshohet se fshihte të ardhurat duke i kaluar në llogari të nënës së tij. Sipas subjektit të rivlerësimit, shuma prej 6.000.000 lekësh që i është dhënë nga nëna e tij, janë të ardhura që qoftë si dhurim, qoftë si kthim huaje, nuk janë subjekt i tatimit. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar gjithashtu se në kontratën e shitjes së njësisë, palët kanë rënë dakord që shpenzimet e shitblerjes dhe regjistrimit të pronës, do të kryheshin nga blerësi. Megjithatë, me qëllim shmangien e çdo pretendimi, prej nënës së tij është paguar detyrimi i papërmblusur në atë periudhë. Në këto kushte, shteti apo shoqëria nuk janë cenuar nga veprimet e kryera në vitin 2005 nga nëna e tij, veprime të cilat pretendohen t'i atribuohen sot subjektit të rivlerësimit, 20 vjet më pas.

- 24.** Nga analizimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

24.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e pasurisë së paluajtshme nr. {***}, *lokal* shërbimesh, në datën 10.01.2005, në Kuçovë, në shumën 12.800.000 lekë. Këto të ardhura nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe as nga personat e lidhur si burim krijimi për pasuritë e deklaruara prej tyre.

24.2. Bashkëlidhur deklaratës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.01.2005, të shitjes së njësisë së shërbimit me sipërfaqe 59 m² në Kuçovë, nga nëna e tij L. D., kundrejt blerësit S. B., në shumën 3.900.000 lekë. Kjo kontratë shitblerjeje është konfirmuar edhe nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kuçovë (në vijim “ZVRPP”), e cila, me shkresën nr. {***} prot., datë 14.09.2017, ka përcjellë në ILDKPKI kontratën e sipërcituar, si dhe kartelën përkatëse të pasurisë, në të cilën njësia e shërbimit figuron e regjistruar në emër të z. S. B., në datën 17.01.2005.

24.3. Në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit nuk i ka identifikuar të ardhurat nga shitja e njësive të shërbimit, si burim të krijimit të pasurive të deklaruara prej tij, për pasojë nuk i ka deklaruar ato. Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozita bankare në emër të tij dhe personit të lidhur, në shumën totale prej 199.800 eurosh.

24.4. Për të provuar deklaratimet e tij lidhur me të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga shitja e njësive të shërbimit në Kuçovë, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision dokumentacionin si vijon:

(i) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.12.2018, e z. S. B., i cili deklaron se me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.01.2005, ka blerë nga znj. L. D., pasurinë e paluajtshme *lokal* shërbimi (bar+bilardo) në Kuçovë, për shumën 12.800.000 lekë. Në kontratën e hartuar para noterit, me kërkesën e tij është shënuar si çmim blerjeje, shuma prej 3.900.000 lekësh, por shuma reale e paguar ka qenë 12.800.000 lekë, e paguar në dy këste, një kësht një muaj më parë dhe një kësht ditën e lidhjes së kontratës. Krahës pagimit të kësaj shume, ka marrë përsipër dhe pagimin e çdo detyrimi që vinte si pasojë e kalimit të pronësisë, si te noterit, ashtu edhe në ZVRPP Kuçovë, meqenëse shitësja i kishte bërë një ulje në çmim prej 200.000 lekësh.

(ii) Vetëdeklarim për legalizim e shtesës së objektit *lokal+bilardo*, i z. S. B..

(iii) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.11.2021, e znj. L. D., e cila deklaron se njësia e shërbimit i është shitur z. S. B., në shumën 12.800.000 lekë. Pagesa është kryer në dy këste me një diferencë afro njëmuajore dhe, pas zbritjes së një shume prej 800.000 lekësh për vajzën e saj, dhe shpenzime familjare e personale, pjesën tjetër e ka ndarë me djalin e saj Arben Dosti, duke marrë secili 6.000.000 lekë, pasi çdo investim në këtë objekt ishte kryer me paratë e tij.

24.5. Për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e njësive të shërbimit, subjekti i rivlerësimit, më datë 24.01.2025, ka depozituar në Kolegj, aktet shkresore si vijnë: (i) Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA 2024), të znj. L. D., në të cilin deklarohen “fitime kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme në pronësi të deklaruesit”, në vlerën bruto 8.900.000 lekë dhe shuma e tatimit të llogaritur për t’u paguar në

vlerën 178.000 lekë; (ii) urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale, datë 22.01.2025, në vlerën 178.000 lekë, shoqëruar me mandatpagesë të Bankës Credins, datë 23.01.2025, për pagesën e vlerës 178.300 lekë, me përshkrim: *Tatim mbi të ardhurat individuale janar - dhjetor në emër të L. D.*.

25. Në analizë të arsyetimit të Komisionit në vendim, pretendimeve të Komisionerit Publik në ankim e parashtrime, atyre të Drejtuesit të Prokurorisë në konkluzionet përfundimtare, si dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me rrethanat faktike që kanë rezultuar nga aktet e administruara, trupi gjykues mori në analizë fillimisht statusin e nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. L. D., në këtë proces, për të përcaktuar më tej, në funksion të këtij statusi, edhe detyrimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me shumën prej 6.000.000 lekësh. Nga verifikimi i deklaratave të interesave të dorëzuara në vite nga subjekti pranë ILDKPKI-së, si dhe referuar të dhënave të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, rezulton se znj. L. D. ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me subjektin, edhe në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, në datën 08.10.2016 e, për pasojë, sipas parashikimit të nenit 13, pika 3 e këtij ligji, znj. L. D. konsiderohet person i lidhur me subjektin e rivlerësimit. Në tërësi, përmbajtja e ligjit nr. 84/2016 dhe, në veçanti, e nenit 30 të tij përcaktojnë se nivelet e kontrollit të pasurisë për personin e lidhur (në këtë rast, nëna e subjektit të rivlerësimit) janë barazuar me ato të parashikuara për vetë subjektin e rivlerësimit. Dispozitat ligjore në fuqi nuk kanë vendosur kufij apo kufizime në drejtim të kontrollit, duke lënë në diskrecion të organeve të rivlerësimit më pas vlerësimin e rezultateve të këtij kontrolli, me qëllim arritjen e një konkluzioni sa më të drejtë lidhur me krijimin e pasurive prej subjekteve dhe personave të lidhur me ta. Sa më sipër, si dhe në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se shuma prej 6.000.000 lekësh është përfituar prej tij nga shitja e pasurisë së paluajtshme në pronësi të nënës së tij (rreth 1/2 e çmimit të shitjes), për shkak të kontributit të dhënë prej tij në privatizimin dhe rikonstruksionin e kësaj pasurie me të ardhurat e përfituara nga puna në emigracion²⁷, trupi gjykues nuk e gjeti të drejtë dhe të bazuar qëndrimin e Komisionit në vendim, i cili i ka konsideruar të ligjshme të ardhurat e sipërcituara, vetëm për faktin se titullare e pasurisë me të drejta dhe detyrime të plota në këtë marrëdhënie juridike, ka qenë vetëm nëna e subjektit të rivlerësimit. Çmimi i shitjes së pasurisë “njësi shërbimi” është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit vetëm gjatë shpjegimeve të dhëna në Komision, si një nga burimet e krijimit të pasurive të tij të deklaruara në deklaratën e rivlerësimit. Referuar kontratës noteriale të shitblerjes, e cila është regjistruar edhe në ZVRPP Kuçovë, çmimi i shitjes është caktuar në vlerën 3.900.000 lekë dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit se ky çmim, në fakt, ka qenë 12.800.000 lekë, nuk mbështetet në asnjë dokumentacion provues ligjor. Përmbajtja e deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.12.2018, e z. S. B., e hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, nuk mund të provojë çmimin real të shitblerjes së pasurisë, për sa kohë nuk mbështetet nga të dhëna, fakte apo indicie të dëshmuara/provuara nga dokumente të tjera. Në këtë drejtim, mbahet në

²⁷ Duke abstraguar nga konkluzioni i arritur më sipër në këtë vendim, se të ardhurat e deklaruara nga subjekti, të pretenduara me burim nga emigracioni, të cilat kanë shërbyer si burim financiar për dhënien e huasë në fjalë, nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme.

vëmendje qëndrimi i mbajtur në jurisprudencën e deritanishme²⁸ të Kolegjit, sipas së cilës vlerat e kontratave të shitblerjeve të pasurive të paluajtshme nuk mund të kundërshtohen apo ndryshohen me akte të prodhuara gjatë dhe në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve. Përmbajtja e vlerave/çmimeve të përcaktuara në këto akte zyrtare, me fuqi të plotë provuese, ka forcën e ligjit për palët²⁹. Për pasojë, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë as gjatë gjykimit në Kolegj, se çmimi real i shitjes së pasurisë “njësi shërbimi” në Kuçovë, ka qenë në vlerën 12.800.000 lekë.

25.1. Referuar akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe të administruara gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues vëren se të ardhurat e pretenduara se janë realizuar realisht nga shitja e njësisë së shërbimit në pronësi të personit të lidhur, znj. L. D., nënës së subjektit të rivlerësimit, në vitin 2005, janë deklaruar pranë organeve tatimore për efekt të shlyerjes së detyrimeve fiskale, në janar të vitit 2025, në një fazë të avancuar të procesit të rivlerësimit, gjatë shqyrtimit të çështjes së subjektit në shkallë të dytë, mbi ankimin e Komisionerit Publik, veprim ky që duket se është kryer vetëm për t’i shërbyer procesit të rivlerësimit (në kushtet e shmangies së pagimit të tij në kohën kur ky detyrim kishte lindur), me qëllim që nëpërmjet pagimit të këtij detyrimi, të provohej çmimi i shitjes së pretenduar prej tij. Trupi gjykues, në mbështetje edhe të jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit në këtë drejtim, vlerësoi se këto të ardhura nuk mund të legjitimohen nga pagesa me vonesë e detyrimeve tatimore për to, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm vetë ekzistencën e këtyre të ardhurave të pretenduara në vlerën 12.800.000 lekë, në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera.

25.2. Sa më sipër, pretendimi i Komisionerit Publik dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme se, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, shuma e pretenduar si e përfituar nga diferenca midis çmimit të shitjes të kontraktuar me çmimin e blerjes të pretenduar, nga shitja e lokalit në Kuçovë, nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme, pasi nuk plotëson kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, është një pretendim i drejtë. Për pasojë, në analizën financiare për verifikimin e mundësisë së subjektit për të krijuar me burime të ligjshme pasuritë e deklaruara, do të konsiderohet vetëm vlera prej 3.900.000 lekësh, si një shumë të ardhurash e konsideruar si e krijuar nga burime të ligjshme financiare. Të ardhurat e pretenduara si të përfituara prej subjektit të rivlerësimit nga shitja e kësaj pasurie, mbi këtë çmim të përcaktuar në kontratë, të padeklaruara dhe për të cilat nuk janë paguar detyrimet tatimore, u vlerësuan nga trupi gjykues se nuk përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për pasurinë “likuiditet” të krijuar me këto të ardhura, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

²⁸ Vendimet e Kolegjit (JR) nr. 16/2019; (JR) nr. 34/2019; (JR) nr. 9/2020 dhe (JR) nr. 41/2022.

²⁹ Sipas nenit 232 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë; si dhe nenit 690 të Kodit Civil, i cili përcakton se kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit midis palëve.

26. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar qëndrimin e Komisionerit Publik, konfirmuar edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, të cilët kanë vlerësuar se, *pavarësisht rrethanave të rastit konkret, ku pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit janë krijuar para fillimit të detyrës, ato i nënshtrohen kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklaramit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim apo ndonjë lloj kriteri përcaktues, sipas standardeve të vendosura nga legjislacioni i posaçëm dhe jurisprudenca tashmë e konsoliduar e Kolegjit.*

26.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se pasuritë objekt shqyrtimi, likuiditete në llogaritë bankare në emër të tij dhe të bashkëshortes, të deklaruar që në deklaratën e parë para fillimit të detyrës, dorëzuar në janar 2014, datojnë dhe i përkasin një periudhe jashtë procesit të rivlerësimit, përpara emërimit të tij në detyrën e gjyqtarit në nëntor 2013, fakt që përjashton në mënyrë kategorike dyshimet mbi abuzimin me këtë detyrë. Subjekti i rivlerësimit ndan qëndrim të kundërt me Komisionerin Publik lidhur me barazimin në kohë të verifikimit të këtyre pasurive, të cilat nuk lidhen dhe nuk janë krijuar me burime të të ardhurave të fituara gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar. Sipas subjektit të rivlerësimit, verifikimi i këtyre pasurive të krijuara përpara fillimit të detyrës, duhet të gëzojë një qasje më garantiste, parë nga ndikimi i rrethanave kohore dhe faktike të ngjarjeve të ndodhura, nga gjurmimi i dokumentacionit shkresor të tyre, çka do të zbehte çdo dyshim të mundshëm mbi pasuri të krijuara në mënyrë të jashtëligjshme. Për periudhën përpara fillimit të detyrës si magjistrat, ai nuk ka pasur pengesë ligjore për t'u marrë me çfarëdo lloj veprimtarie ekonomike për të krijuar të ardhura pasurore dhe, në këto kushte, subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat objekt kontrolli prezumohen të ligjshme dhe e kundërta duhet të provohet nga organi procedues.

27. Në premisë të analizës, trupi gjykues çmon të theksojë se në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, në procesin e rivlerësimit (duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal), barra e provës është e zhvendosur te subjekti i rivlerësimit, pra i përket këtij të fundit detyrimi për të provuar pretendimet e tij, duke paraqitur prova e fakte që kundërshtojnë gjetjet e organeve të rivlerësimit, në kuadër të këtij procesi.

27.1. Në vijim të arsytimit, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në vendim³⁰, ka arsyetuar: “[...] duke marrë parasysh vetë kohën në të cilën janë krijuar këto të ardhura të deklaruar si burim për krijimin e pasurive të shpjeguara si më lart, konstaton se ato janë realizuar shumë kohë para miratimit dhe hyrjes në fuqi të paketës kushtetuese të reformës në drejtësi, duke përfshirë dhe ligjin nr. 84/2016, të cilët përcaktuan rregulla specifike në drejtim të provueshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të siguruara nga subjektet e rivlerësimit, për efekt të kontrollit e verifikimit të pasurive të tyre. Për më tepër, rezulton se ato janë krijuar edhe shumë kohë para fillimit të detyrës. Në këtë kuptim, standardi i provueshmërisë për këto të ardhura duhet të jetë ai i nxjerrjes së justifikimit bindshëm edhe për një nivel më të ulët të provave, sesa do të duhej për të kënaqur

³⁰ Paragrafi 34.37 i vendimit të Komisionit.

standardin e provueshmërisë për pasuritë e vëna gjatë ushtrimit të detyrës apo periudhës së rivlerësimit. Kjo mënyrë e të arsyetuarit lidhet me logjikën se këto të ardhura, me të cilat janë krijuar pasuri, presupozohen që janë vënë duke mos abuzuar me detyrën (që efektivisht nuk mbahej) dhe as ndonjë funksion tjetër publik dhe, për pasojë, duke shmangur për këto pasuri mundësinë e mosbesimit të publikut drejt ligjshmërisë së krijimit të tyre”.

27.2. Për t’u dhënë zgjidhje pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, të cilat duket se mbështeten në qëndrimin e mbajtur nga Komisioni në vendim, qëndrim i kundërshtuar nga Komisioneri Publik në ankim dhe i konfirmuar dhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, trupi gjykues mori në analizë konkluzionet lidhur me çështjet e analizuara më sipër në këtë vendim, vlerësimi i të cilave u krye në kontekstin e matjes së peshës që ato duhet të kenë në procesin e rivlerësimit të subjektit, duke konstatuar e vlerësuar sa vijon.

Siç është evidentuar edhe më sipër në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me asnjë formë krijimin e të ardhurave të pretenduara në emigracion, në drejtim të ekzistencës së tyre, vlerës, kohës së krijimit, si edhe të plotësimit të kriterëve të ligjshmërisë, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore. Në këtë kuptim, çdo pasuri e krijuar me këto të ardhura rezulton e pambuluar me burime financiare të ligjshme, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

27.3. Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, vëren se është i drejtë konstatimi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në konkluzionet përfundimtare, se të ardhurat të cilat subjekti i rivlerësimit ka arritur të provonte me dokumentacion ligjor, kanë vlerën 10.246.150 lekë, ndërsa pasuria e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit me burim këto të ardhura, rezulton të jetë në vlerën 195.000 euro dhe 4.950.000 lekë (ose rreth 31.000.000 lekë në total). Këto shifra, në vlerësimin e trupit gjykues, e bëjnë të pamundur zbatimin e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, për sa kohë që balanca negative rezulton të jetë shumë e thellë, duke u vlerësuar si një mungesë e rëndësishme, e cila cenon standardin kushtetues të provimit bindshëm të ligjshmërisë së pasurisë.

27.4. Argumenti se pasuria “likuiditet në *cash*”, e cila ka shërbyer si burim financiar krijimi për pasuritë e deklaruar në deklaratën e rivlerësimit, është krijuar para fillimit të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit, nuk vjen në harmoni me qëndrimet e mbajtura prej Kolegjit në rastet të tjera të ngjashme³¹, në të cilat këto pasuri të krijuara para marrjes së detyrës së magjistratit, i janë nënshtruar analizës dhe kontrollit të burimeve të krijimit dhe subjektet janë ndëshkuar kur shkeljet e konstatuara janë konsideruar të pakapërcyeshme e të rëndësishme për vlerësimin e pasurive të tyre. Sipas jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, referuar kuadrit ligjor kushtetues dhe legjislacionit të posaçëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, në asnjë dispozitë nuk parashikohen kriterë vlerësimi të kushtëzuara me periudha kohore të krijimit të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me ta, me qëllim përfshirjen apo përjashtimin e tyre nga objekti i kontrollit të organeve të rivlerësimit. Sikurse është elaboruar

³¹ Vendimet e Kolegjit nr. 49/2023 (JR), datë 09.11.2023; nr. 30/2023 (JR), datë 14.07.2023; nr. 8/2023 (JR), datë 02.03.2023; nr. 3/2022 (JR), datë 23.02.2022; nr. 19/2019 (JR), datë 26.07.2019 etj.

tashmë nga Kolegji, nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit që janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive për të cilat nuk mund të justifikohet ligjërisht burimi i tyre apo që posedojnë të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj. Në rastin konkret, verifikimi dhe qartësimi i kriterit të pasurisë për periudhën përpara vitit 2013 – kur subjekti i rivlerësimit ka hyrë në sistemin e drejtësisë nëpërmjet emërimit të tij si magjistrat gjyqtar dhe, për rrjedhojë, marrjes prej tij të cilësisë “subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003”, merr rëndësi të posaçme në kontekstin e procesit të rivlerësimit. Sikurse subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjatë procesit të rivlerësimit dhe në deklaratat vjetore periodike të interesave, pasuritë e krijuara përpara vitit 2013, kanë shërbyer si burim i krijimit të pasurive në vitet në vijim, për rrjedhojë trupi gjykues vlerëson se është e drejtë dhe e bazuar në ligj analiza, si dhe verifikimi e vlerësimi i burimit të ligjshëm të krijimit të tyre.

28. Në vlerësimin tërësor të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë e të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Pretendimi dhe argumentet e subjektit të rivlerësimit se pasuritë që kanë shërbyer si burim krijimi për pasuritë e deklaruara në deklaratën e rivlerësimit janë krijuar para detyrës së gjyqtarit dhe nuk duhet të ngarkojnë atë me përgjegjësi për këtë arsye, u gjetën nga trupi gjykues si të pamjaftueshme për të mos aplikuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
29. Në kushtet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi si të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme se mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, është e mjaftueshme për të konkluduar se subjekti nuk arriti një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe duhet të gjejë vend zbatimi i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, e parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

C. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës

30. Lidhur me këtë kriter, Komisioni, fillimisht, ka administruar raportin e DSIK-së për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Arben Dosti³², me konstatimin për përshtatshmërinë e tij në vazhdimin e detyrës. Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucionet e verifikimit, DSIK-ja, me anë të raportit nr. {***} prot., datë 04.02.2021³³, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit dhe i ka referuar Komisionit se: *Për z. Arben Dosti ka dyshime [...] mund të ketë qenë i përfshirë në trafikun e narkotikëve, si dhe të shfrytëzimit të prostitucionit në*

³² Raporti është përcjellë në Komision nga DSIK-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017.

³³ Raport i deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së, nr. {***}, datë 18.03.2021.

*Greqi dhe Itali, në bashkëpunim me persona të tjerë. Nga informacione [...] dyshohet se Arben Dosti, gjatë viteve 1997-1998, ka qenë i dënuar me burg në Milano, Itali, për trafik lëndësh narkotike, periudhë në të cilën mendohet të ketë përdorur gjeneralitete të tjera. Në konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar: Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dosti. Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.10.2021, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, për të kërkuar informacion pranë autoriteteve gjyqësore përkatëse në lidhje me faktin nëse për subjektin e rivlerësimit (me gjeneralitet e deklaruar prej tij në formularin në shtojcën përkatëse të ligjit nr. 84/2016) ekziston ndonjë vendim gjyqësor penal, dhënë nga juridiksioni gjyqësor në Republikën e Greqisë dhe Republikën e Italisë. Mbi këtë kërkesë të Komisionit, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, më datë 02.11.2021, u ka përcjellë kërkesën për informacion ministrive respektive në Republikën e Greqisë dhe Republikën e Italisë.*

31. Komisioneri Publik, në ankim, nga konstatimi i situatës faktike si më sipër pasqyruar, ka parashtruar se Komisioni, megjithëse vlerësoi si të nevojshme marrjen e informacionit pranë autoriteteve përkatëse të Republikës së Italisë dhe Greqisë, zhvilloi seancën dëgjimore publike në datën 25.11.2021 dhe shpalli vendimin përkatës në datën 03.12.2021, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit *ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016*, pa administruar në dosjen e hetimit administrativ ndonjë përgjigje në lidhje me kërkesën drejtuar autoriteteve të huaja³⁴.

31.1. Në ankim, Komisioneri Publik ka referuar se në datën 26.01.2022, nga Komisioni është përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë një kopje e shkresës së Ministrisë së Drejtësisë me nr. {***} prot., datë 24.01.2022, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 26.01.2022, me anë të së cilës dërgohet përgjigjja e autoriteteve përkatëse të Republikës së Italisë, nga ku rezulton se me gjeneralitetet e subjektit të rivlerësimit, nuk ka të dhëna në bankën e të dhënave të sektorit gjyqësor. Sipas Komisionerit Publik, deri në momentin e depozitimit të këtij ankimi, në asnjë formë komunikimi, nuk i është vënë në dispozicion për t'u shqyrtuar ndonjë përgjigje nga ana e autoriteteve përkatëse të Republikës së Greqisë, nëse në ngarkim të subjektit të rivlerësimit është dhënë ndonjë vendim gjyqësor penal gjatë qëndrimit të tij në territorin grek.

31.2. Bazuar në situatën faktike si më sipër, Komisioneri Publik ka pretenduar se *për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Arben Dosti, informacionet e institucioneve verifikuese mundën eventualisht të rivlerësohen nga Kolegji, qoftë në rivlerësimin e kriterit të figurës dhe/ose në vlerësim tërësor të procedurave, për të krijuar bindjen e plotë se subjekti nuk ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë apo ndodhet në kushtet e papërshtatshmërisë për të vazhduar detyrën.*

31.3. Gjatë gjykimit në Kolegj, Komisioneri Publik potencoi qëndrimin e tij të parashtruar në ankim, lidhur me konstatimet për sa i përket vlerësimit të Komisionit mbi kriterin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit.

³⁴ Paragrafi 25.1.3. i ankimit.

32. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të shkakut të ankimit, në procesin e zhvilluar në Kolegj, ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ në Komision, duke parashtruar se Komisioneri Publik, në momentin e ankimit, nuk ka verifikuar gjendjen e plotë të akteve të dosjes së tij të rivlerësimit, pasi në seancën dëgjimore publike të zhvilluar në Komision, ai ka depozituar vërtetimet negative të gjendjes gjyqësore të marra në Itali dhe në Greqi. Sipas subjektit të rivlerësimit, këto dy akte të shqyrtuara nga Komisioni, duhet të ishin marrë në konsideratë edhe nga Komisioneri Publik. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se prej muajit korrik të vitit 1992 (periudhë në të cilën ka përfunduar shkollën e mesme në qytetin e Kuçovës) e deri në maj të vitit 2002 ka qëndruar dhe punuar në shtetin e Greqisë dhe, pas kthimit në Shqipëri, ka qëndruar në Kuçovë, duke u marrë me aktivitet privat, vazhduar shkollën e lartë, si edhe duke u angazhuar në veprimtari publike dhe pozicionet që ai ka mbajtur në partinë politike ku ka aderuar, nuk kanë qenë me emërim, por me zgjedhje nga anëtarësia dhe, si rrjedhim, në një qytet të vogël si Kuçova, nëse do të kishte kontestime apo dyshime për figurën e tij, nuk do të kishte mundësi të kandidonte dhe jo më të ishte fitues. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar gjithashtu se bashkëshortja e tij në vitet 2015- 2016, ka punuar në Sektorin e Kontrollit të Brendshëm të Policisë së Burgjeve, institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, dhe se për efekt të pozicionit të punës, është pajisur nga DSIK-ja me certifikatë sigurie “Për njohje me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, kategoria e certifikatës “Tepër sekret”, pasi janë kryer nga ky institucion të gjitha verifikimet e nevojshme për figurën e tij dhe të bashkëshortes. Raportin e DSIK-së që ka konstatuar papërshtatshmërinë e tij për vazhdimin e detyrës mbi dënimet e supozuara në dy shtete, subjekti i rivlerësimit e konsideroi të bazuar në shpifje individësh të caktuar, të cilët kanë dashur të hedhin baltë mbi të, ndaj të cilëve ai ka paraqitur kallëzim penal dhe çështjet janë në proces e sipër.
33. Në bisedimet përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerësoi se, në kushtet kur gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, situata faktike lidhur me mungesën e përgjigjes nga ana e autoriteteve përkatëse të Republikës së Greqisë, për të verifikuar në rast se në ngarkim të subjektit të rivlerësimit është dhënë ndonjë vendim gjyqësor penal gjatë qëndrimit në territorin grek, mbeti e pandryshuar, raporti i DSIK-së nr. {***} prot., datë 04.02.2021, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Arben Dosti, mbetet akti i referuar, për sa përmban si konstatim.
34. Subjekti i rivlerësimit, në bisedimet përfundimtare, përpos sa parashtrroi gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, pretendoi se kërkesa e tij për deklasifikimin e informacionit mbi të cilin DSIK-ja ka mbështetur raportin për kriterin e figurës, duke konstatuar papërshtatshmërinë e tij për vazhdimin e detyrës, u rrëzua pa të drejtë nga Kolegji, pasi ai ka të drejtë të njihet dhe t’i vihej në dispozicion ky informacion, i cili është verifikuar nga Komisioni dhe më pas edhe nga Kolegji, i cili ka nxjerrë një opinion mbi të dhënat e verifikuara në DSIK. Sipas subjektit të rivlerësimit, e drejta e tij për t’u njohur me këtë informacion buron nga parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në një proces gjyqësor, i njohur nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

34.1. Sa i përket këtij pretendimi, trupi gjykues vlerësoi se kufizimi i së drejtës së subjektit të rivlerësimit për njohjen me këtë informacion, ishte i nevojshëm dhe proporcional, në raport me paprekshmërinë dhe sigurinë e burimeve të këtij informacioni. Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerësoi se kufizimi i këtij informacioni nuk ka cenuar të drejtën e mbrojtjes së subjektit të rivlerësimit, sipas vlerësimit të jurisprudencës së GjEDNj-së në çështjen *Regner kundër Republikës Çeke*, pasi subjektit të rivlerësimit, në Komision edhe në Kolegj, iu dha mundësia të sqarojë qëndrimin e tij lidhur me sa ka rezultuar nga ky informacion, si dhe të paraqesë prova për të provuar gjendjen e tij gjyqësore në raport me dënime penale të dhëna nga autoritetet e shtetit grek dhe italian. Për pasojë, kufizimi i të drejtës së subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", u vlerësua nga trupi gjykues në përputhje me garancitë për një proces të rregullt ligjor, nën dritën e parashikimeve të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

35. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të akteve të administruara gjatë hetimit administrativ të kryer në Komision dhe atyre të administruara gjatë gjykimit në Kolegj, në vijim të situatës faktike të pasqyruar në paragrafin 30 më sipër në këtë vendim, konstatoi dhe vlerësoi si vijon.

35.1. KLGj-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.10.2021, ka përcjellë në Komision kopje të formularit të vetëdeklarimit të gjyqtarit Arben Dosti, depozituar në datën 18.04.2016, sipas parashikimeve të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në të cilin subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: (i) *nuk është dënuar ndonjëherë me vendim të formës së prerë apo jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj; (ii) nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose në gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e ndonjë vepre penale; (iii) nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale; (iv) ndaj tij nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale; (v) nuk është lëshuar ndonjëherë ndaj personit të tij urdhër kërkimi ndërkombëtar për kryerjen e ndonjë vepre penale.*

Gjithashtu, në këtë formular, subjekti ka deklaruar se ka jetuar në Tinos dhe Athinë, Greqi, për arsye punësimi, në periudha të caktuara, nga viti 1992 deri në vitin 2000.

35.2. Prokuroria e Përgjithshme, mbi kërkesën e Komisionit, e ka informuar këtë të fundit me anë të shkresës nr. {***}, datë 14.10.2021, se nuk janë kryer verifikime për subjektin Arben Dosti, në bazë të parashikimeve të ligjit nr. 138/2015.

35.3. Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.10.2021, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar informacion mbi ekzistencën e ndonjë dënimi penal në shtetin grek dhe/ose italian për subjektin e rivlerësimit dhe vendosjen në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit përkatës. Nga verifikimi i dosjes së rivlerësimit të përcjellë nga Komisioni në Kolegj, konstatohet se në të është administruar vetëm shkresa nr. {***} prot., datë 02.11.2021, e Ministrisë së Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Transparencës dhe të Drejtave të Njeriut të Republikës së Greqisë, por nuk ka një kthim përgjigjeje të kësaj të fundit. Gjithashtu, është administruar shkresa nr. {***} prot., datë 04.11.2021, e

Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë dhe shkresa nr. {***} prot., datë 24.01.2022, e Ministrisë së Drejtësisë, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 26.01.2022, me anë të së cilës dërgohet përgjigjja e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë³⁵, nga ku rezulton se, me gjeneralitetet e subjektit të rivlerësimit, nuk ka të dhëna në bankën e të dhënave të sektorit gjyqësor.

35.4. Në seancën dëgjimore publike të zhvilluar në Komision më datë 25.11.2021, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës, aktet si vijojnë.

(i) Dëshmi penaliteti për përdorim të përgjithshëm, lëshuar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Greqisë, me kod {***} dhe nr. {***} prot., datë 17.11.2021, me anë të së cilës vërtetohet se gjendja penale e z.Arben Dosti, sipas të dhënave që deri më 17.11.2021, janë regjistruar në bazën e të dhënave të Sistemit të Integruar Informativ të Amzës Kombëtare Penale, është zero. Dokumenti është paraqitur i legalizuar me vulë apostile, i përkthyer dhe vërtetuar nënshkrimi i përkthyesit me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 24.11.2021.

(ii) Certifikatë e gjendjes gjyqësore nr. {***}, lëshuar nga Sistemi Informatik i Gjendjes Gjyqësore të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë, nxjerrë nga Arkivi i Gjendjes Gjyqësore-Prokuroria e Republikës pranë Gjykatës së Lagonegros, më datë 17.11.2021, me anë të së cilës vërtetohet se në Bankën e të Dhënave të Gjendjes Gjyqësore, subjekti rezulton i padënuar. Dokumenti është paraqitur i legalizuar me vulë apostile, i përkthyer dhe vërtetuar nënshkrimi i përkthyesit me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 25.11.2021.

(iii) Vërtetim mbi procedime penale në proces, lëshuar nga Prokuroria e Republikës Lagonegro, datë 17.11.2021, me anë të të cilit vërtetohet se nga Regjistri Elektronik i Njoftimit të veprave Penale pranë kësaj prokurorie, me të dhënat e përditësuara deri më datë 17.11.2021, për subjektin, nuk rezultojnë procedime penale në proces. Dokumenti është paraqitur i legalizuar me vulë apostile, i përkthyer dhe vërtetuar nënshkrimi i përkthyesit me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 25.11.2021.

36. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, në vendim³⁶, ka arritur në konkluzionin, se: *Sikurse u konstatua më sipër, vetë organet e verifikimit kanë referuar se informacionet të cilat ngrenë dyshime se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dosti, mund të ketë qenë i përfshirë në vepra të rënda kriminale, nuk janë të konfirmuara. Edhe nga hetimi i kryer, nuk rezultuan të dhëna të cilat mund të ngrenë dyshime për përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në vepra penale apo, për më tepër, dënimin e tij në shtet të huaj, me burgim. Sa më sipër, nga analizimi në tërësi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, provave të administruara gjatë hetimit administrativ, si edhe atyre të depozituara me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit dhe gjatë seancës dëgjimore, Komisioni arrin në përfundimin se për subjektin e rivlerësimit Arben Dosti: nuk provohet ekzistenca e ndonjë mase sigurimi apo dënimi penal në shtet të huaj; nuk provohen*

³⁵ Shkresa e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë me nr. {***}, datë 15.12.2021.

³⁶ Paragrafët 42-43 të vendimit të Komisionit.

dyshimet e ngritura për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme; nuk provohet ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme.

Si rrjedhim, Komisioni i qëndron konstatimit fillestar se për subjektin e rivlerësimit Arben Dosti, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit Arben Dosti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

37. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të pretendimeve të tij se nuk ka qenë asnjëherë i dënuar penalisht në shtetin grek apo italian, ka paraqitur aktet shkresore të cilat u administruan në cilësinë e provës, si vijojnë.

(i) Dëshmi penaliteti për përdorim të përgjithshëm, lëshuar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Greqisë³⁷, me kod {***}, dhe nr. {***}, datë 21.11.2024, me anë të së cilës vërtetohet se gjendja penale e Arben Dosti, sipas të dhënave që deri më datë 21.11.2024 janë regjistruar në bazën e të dhënave të sistemit të integruar të informacionit të regjistrimit kombëtar penal, është zero.

(ii) Vendim “Për shpalljen e moskompetencës lëndore dhe kalimin e akteve” i datës 25.07.2022, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, sipas të cilit është vendosur shpallja e moskompetencës së kësaj gjykate për hetimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2022, e regjistruar mbi bazën e kallëzimeve penale të shtetasit T. N. dhe Arben Dosti, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Nga parashtrimi i rrethanave të faktit në këtë vendim, rezulton se në ankesën e regjistruar pranë KLGj-së me nr. {***} prot., datë 22.04.2022, e cila supozohej e dërguar nga avokati T. N., ndër shkeljet e pretenduara për n/kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë asokohe Arben Dosti, renditej edhe se: “Shtetasi Arben Dosti është i lakuar në gjithë zonën e tij si i dënuar për trafikë jashtë vendit dhe që nuk u verifikua as nga KPK-ja”.

(iii) Shkresë kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 18.12.2024, e AKSIK-ut, nëpërmjet së cilës informohet subjekti i rivlerësimit se, në përgjigje të kërkesës së tij për deklasifikimin e plotë të raportit të DSIK-së, i përcillet raporti i deklasifikuar pjesërisht me nr. {***} prot., datë 04.2.2021, të administruar edhe nga Komisioni.

38. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, në përgjigje të kërkesës së relatores së çështjes³⁸, Ministria e Drejtësisë ka vënë në dijeni Kolegjin se i është drejtuar përsëri Ministrisë së Drejtësisë së

³⁷ Dokumenti është paraqitur i legalizuar me vulë apostile, i përkthyer dhe vërtetuar nënshkrimi i përkthyesit me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 18.12.2024.

³⁸ Nisur nga fakti që në fashikullin e Komisionit nuk rezultonte i administruar dokumentacion lidhur me ndonjë përgjigje të Ministrisë së Drejtësisë së Greqisë mbi dënime penale të dhëna ndaj subjektit të rivlerësimit në shtetin grek, bazuar në kërkesën me nr. {***} prot., datë 15.10.2021, që Komisioni i drejtonte Ministrisë së Drejtësisë së Shqipërisë, relatorja e çështjes, sipas parashikimeve të nenit 14, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, iu drejtua

Republikës së Greqisë për të dhënë informacion lidhur me dënime penale të subjektit të rivlerësimit nga autoritetet greke të drejtësisë. Gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor në Kolegj, nuk u administrua ndonjë përgjigje zyrtare nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Greqisë lidhur me dënime penale të dhëna nga autoritetet e drejtësisë greke ndaj subjektit të rivlerësimit.

39. Trupi gjykues, më datë 09.01.2025, verifikoi pranë institucionit të Shërbimit Informativ të Shtetit, informacionin që ishte pjesë e raportit të DSIK-së mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me të cilin ishte njohur edhe Komisioni gjatë hetimit administrativ.
40. Në konkluzion, në konsideratë të faktit se gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, situata faktike mbeti e pandryshuar sa i përket dhënies së një vendimi gjyqësor penal nga autoritetet greke të drejtësisë ndaj subjektit të rivlerësimit, për shkak të mungesës së përgjigjes nga autoritetet përkatëse të Republikës së Greqisë, bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të Komisionit, si dhe në informacionet me të cilat u njoh pranë organeve ligjzbatuese, trupi gjykues e gjen të pandryshueshëm vlerësimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit Arben Dosti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Ç. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

41. Komisioneri Publik, në analizë të provave dhe akteve të administruara, ka vlerësuar në ankim, se përfundimi i Komisionit për rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, është i cënueshëm pasi, referuar rezultateve të hetimit administrativ mbi kontrollin e këtij kriteri, mangësitë e vërejtura janë të tilla që nuk justifikojnë ose nuk krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit duhet të konfirmohet në detyrë, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe/ose në vlerësim tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 61, pika 5 e të njëjtit ligj.

41.1. Komisioneri Publik ka ndarë qëndrim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me gjetjet e konstatuara në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, duke ngritur pretendime për çështjet gjyqësore të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, të cilat u analizuan nga trupi gjykues, si më poshtë.

42. Lidhur me denoncimin e depozituar në Komision nga znj. Y. Sh. (Xh.)³⁹, Komisioneri Publik ka pretenduar, në ankim, se *të dhënat e rezultuara në rastin konkret, nga hetimi administrativ, lidhur me cilësinë e analizës dhe të argumentimit logjik të subjektit të rivlerësimit, mbeten për t'u vlerësuar sipas indikatorëve të përcaktuar nga neni 72, pika e 3 e ligjit nr. 96/2016.*

*Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. {***} regj., datë 16.10.2024, lidhur me faktin nëse nga ky institucion ishte administruar një përgjigje nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Greqisë.*

³⁹ *Denoncim i regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 01.12.2017.*

42.1. Komisioni ka marrë në shqyrtim denoncimin e znj. Y. Sh. (Xh.), e cila ka ngritur pretendime se gjyqtari Arben Dosti, në shkelje të ligjit, ka vendosur lirimin me kusht të ish-bashkëshortit të saj, edhe pse ky i fundit ka qenë i dënuar për disa vepra penale. Pas administrimit të dosjes gjyqësore⁴⁰, Komisioni ka marrë në analizë çështjen penale për të cilën është dhënë vendimi nr. {***}, datë 27.12.2016, me kërkesë shtetasin E. Xh. dhe me objekt “Lirim me kusht” dhe në vendim⁴¹, ka konkluduar se: [...] *Komisioni nuk vërejtí problematíka në vendimmarrjen e subjektit për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit lidhur me këtë denoncim janë bindëse dhe se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe/apo për figurën e subjektit të rivlerësimit.*

42.2. Komisioneri Publik, duke kundërshtuar qëndrimin e Komisionit, ka argumentuar në ankim dhe në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, se të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ, lidhur me cilësinë e analizës dhe të argumentimit logjik të subjektit të rivlerësimit, mbeten për t’u vlerësuar sipas indikatorëve të përcaktuar nga neni 72, pika e 3 e ligjit nr. 96/2016, referuar dhe jurisprudencës së Kolegjit, pasi qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me zbatimin e neneve 55 dhe 64 të Kodit Penal, për verifikimin ose jo si përsëritës në kryerjen e veprave penale të kryera me dashje, të personit nën gjykim në çështjen objekt kontrolli, nuk gjen mbështetje në situatën faktike dhe juridike të rastit konkret, duke evidentuar minimalisht dobësi/mangësi në aftësitë profesionale të subjektit. Sipas Komisionerit Publik, bashkimi i dënimeve në një të vetëm nuk mund të interpretohet si rrethanë e cila karakterizon personin që ka kryer disa vepra penale si person jopërsëritës dhe të legjitimojë dhënien ndaj tij të masës “Lirim me kusht”. Komisioneri Publik ka pretenduar gjithashtu se duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë në konsideratë as elementet e trajtuara nga Gjykata e Lartë në vendimin unifikues nr. 2, datë 25.05.2015, në të cilin është interpretuar se: [...] (i) Natyra e veprës penale të kryer është një nga elementet më të rëndësishme që duhet të merret parasysh nga ana e Gjykatës në shqyrtimin e kërkesës për lirim me kusht. Sa më e lartë të jetë rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të kryer, aq më i thellë duhet të jetë hetimi gjyqësor në lidhje me riedukimin e të dënuarit. (ii) Qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës është elementi i dytë që ligji parashikon për t’u trajtuar në raportin e Drejtorit të IEVP-së. Pendimi i të dënuarit duhet të rezultojë nga të dhëna objektive [...].

42.3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare, në mbështetje të shkakut të ankimit, si dhe sa referuar nga subjekti i rivlerësimit, parashitroi gjatë gjykimit në Kolegj, se ndaj shtetasit E. Xh., në momentin e gjykimit të kërkesës për lirim me kusht, rëndonin dy vendime gjykate të formës së prerë, sipas të cilëve ai ishte dënuar me burgim për kryerjen me dashje të dy veprave penale të kryera në periudha të ndryshme, konkretisht, për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a, paragrafi 4 i Kodit Penal, në lidhje me faktin penal të

⁴⁰ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me shkresën nr. {***} prot., datë 28.09.2021 ka përcjellë në Komision dosjen gjyqësore.

⁴¹ Paragrafi 49 i vendimit të Komisionit.

kallëzuar në datën 30.10.2013, nga bashkëshortja Y. Xh., si dhe për veprën penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga nenet 278/2 dhe 278/3 të Kodit Penal, në lidhje me faktin penal të konstatuar më datë 27.03.2014, ku gjatë kontrollit të banesës së këtij shtetasi, është gjetur dhe sekuestruar një armë zjarri automatike dhe municione. Për pasojë, shtetasi E. Xh. ka qenë përsëritës në krim, kriter ndalues në aplikimin e nenit 64 të Kodit Penal.

42.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtime dhe në bisedimet përfundimtare, kundërshtoi shkakun e ankimit duke deklaruar se i qëndron plotësisht vendimmarrjes dhe arsytimit të tij në vendimin nr. {***}, datë 27.12.2016, për lirim me kusht të të dënuarit E. Xh., duke paraqitur të njëjtat argumente si gjatë hetimit administrativ në Komision se, referuar akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore, rezulton se IEPV Tepelenë, në raportet e datave 21.07.2016 dhe 06.12.2016, ka vlerësuar pozitivisht të dënuarin gjatë kohës së vuajtjes së dënimit. Sipas subjektit të rivlerësimit, në raportin e vlerësimit të Shërbimit të Provës Gjyrokastër, datë 22.12.2016, është evidentuar se nga gjendja shëndetësore, i dënuari ka qenë dhe është i sëmurë {***}, {***} dhe {***}. Njëkohësisht është evidentuar dhe gjendja e tij e vështirë ekonomike, si dhe mospasje e ndihmës së familjes për integrim, pasi marrëdhëniet në familje mes të dënuarit dhe bashkëshortes së tij kishin mbaruar përfundimisht për shkak të zgjidhjes së martesës mes tyre. Subjekti i rivlerësimit argumentoi në vijim se qëllimi i dënimit penal nuk është ndëshkimi, por rehabilitimi, risocializimi i personave në shoqëri, ashtu siç ka interpretuar dhe Gjykata e Lartë me vendimin unifikues nr. 2, datë 25.05.2015, orientimet e së cilës janë mbajtur në konsideratë prej tij në rastin konkret. Sipas subjektit, konsiderohet përsëritës, në kuptim të nenit 64 të Kodit Penal, një person i cili është dënuar me një vendim penal, ka vuajtur dënimin penal dhe më pas kryen një vepër tjetër penale me dashje. Për këtë person, procesi risocializues ka dështuar dhe, në këto kushte, nuk është subjekt i lehtësirave penale. Nëse një person në një gjykim dënohet për dy ose më shumë vepra penale, atëherë ky person nuk mund të quhet përsëritës, pasi ndaj tij nuk ka pasur më parë periudhë rehabilitimi/risocializimi. I njëjti arsyetim vlen edhe kur një person dënohet me dy vendime penale të ndryshme, me trupa gjykues të ndryshëm, për të cilat, si në rastin konkret, kryhet bashkimi i dënimeve dhe periudha e vuajtjes së dënimit, pra risocializimit, është e njëjtë. Në çështjen konkrete, subjekti ka vlerësuar se personi i dënuar nuk mund të ishte peng i paqartësive ligjore dhe çdo interpretim dhe zbatim i ndryshëm i ligjit duhet të kryhej në favor të tij. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimi i dhënë prej tij, ka qenë në zbatim të drejtë të ligjit material dhe procedural penal dhe pretendimin e Komisionerit Publik e ka konsideruar të pabazuar në ligj dhe në praktikën gjyqësore në gjykata.

43. Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara nga Komisioni dhe nga aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues konstatoi si vijon.

43.1. Me vendimin nr. {***}, datë 23.06.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër ka deklaruar fajtor të pandehurin E. Xh., për veprën penale “Dhunë në familje”, të parashikuar nga neni 130/a, paragrafi 4 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 18 muaj burgim. Ky vendim është

ndryshuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, e cila, me vendimin nr. {***}, datë 26.11.2014, ka vendosur dënimin e të pandehurit E. Xh. me 1 vit burgim.

43.2. Me vendimin nr. {***}, datë 19.12.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka deklaruar fajtor të pandehurin E. Xh. për veprën penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga nenet 278/2 dhe 278/3 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 8 muaj burgim.

43.3. Me vendimin nr. {***}, datë 05.02.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka kryer bashkimin e dënimeve të mësipërme, duke caktuar ndaj shtetasit E. Xh. një dënim të vetëm, prej 13 muajsh burgim.

43.4. Duke pretenduar se plotëson kriteret e nenit 64 të Kodit Penal, i dënuari E. Xh. ka paraqitur kërkesë për lirimin me kusht, e cila është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me gjyqtar të vetëm subjektin e rivlerësimit. Gjatë gjykimit, prokurori ka parashtruar se kërkuesi E. Xh. ka dy dënime penale për vepra penale të kryera me dashje, duke e konsideruar atë përsëritës, për pasojë ai nuk plotësonte një nga kushtet të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, për aplikimin e nenit 64 të Kodit Penal, për lirimin me kusht të kërkuesit.

43.5. Nga kartela personale e të dënuarit E. Xh., rezulton se ky shtetas ka qenë i dënuar me një vit e një muaj burg sipas vendimit nr. {***}, datë 05.02.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë (për bashkimin e dy dënimeve), i cili ka marrë formë të prerë më datë 16.12.2015 dhe është ekzekutuar më datë 26.12.2015.

43.6. Raporti i vlerësimit të Shërbimit të Provës Gjirokastrë, datë 22.12.2016, përshkruan sjellje të mirë të të dënuarit E. Xh. gjatë vuajtjes së dënimit (citohet se ka vuajtur gjithsej 11 muaj, mbetur pa vuajtur 2 muaj), një gjendje shëndetësore dhe emocionale jo të mirë për shkak të disa sëmundjeve për të cilat trajtohej, si dhe kushte ekonomike e sociale të vështira të familjes.

43.7. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. {***}, datë 27.12.2016, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe, bazuar në nenin 64 të Kodit Penal, lirimin e të dënuarit E. Xh., duke urdhëruar pezullimin e pjesës së mbetur pa vuajtur prej 52 ditësh burgim dhe vënien në provë për një periudhë prej 52 ditësh. Në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se: *Në lidhje me pretendimin e prokurorit të seancës se kërkuesi ka dy dënime penale për vepra penale të kryera me dashje dhe, si pasojë, konsiderohet përsëritës, gjykata vlerëson se ky pretendim është i pabazuar. Rezulton se kërkuesi ka dy dënime penale dhënë njëri pas tjetrit, për të cilat organi i akuzës ka kërkuar bashkimin e tyre në gjykatë. Kërkuesi ka filluar vuajtjen e dënimit pas dhënies së vendimit për bashkim dënimesh. Rezulton se në bashkim të dënimeve, ndaj kërkuesit është caktuar një dënim i ri, të cilin kërkuesi po e ekzekuton. Gjykata çmon se, në rastin në shqyrtim, ndodhemi në të njëjtat kushte kur në të njëjtin gjykim ndaj të pandehurit, gjykata jep dy dënime për vepra penale të ndryshme dhe bën bashkimin e tyre në një të vetëm, neni 55 i Kodit Penal. Në kushtet kur kemi dy dënime të bashkuara në një, nuk mund të themi që kërkuesi po kryen njërin nga dënimet dhe është*

përsëritës për tjetrin, pasi ai po kryen një dënim të vetëm, të dhënë me vendim gjykate. Vendimi i gjykatës për bashkimin e dënimeve nuk është një vendim vetëm për efekt ekzekutimi të vendimeve dhënë më parë. Në këtë vendim, është caktuar një dënim i ri, i vetëm për t'u vuajtur, i cili nuk është shumatore e vendimeve të mëparshme. Qëllimi i nenit 64 të Kodit Penal është që personave t'u jepet një mundësi rehabilitimi dhe risocializimi. Në rast se dënohen përsëri, që do të thotë që procesi i rehabilitimit ka dështuar, legjislatori ka vendosur si kusht mospërfitimin nga neni 64. Në rastin në shqyrtim, nuk rezulton që kërkuesi të ketë vuajtur më parë një dënim penal dhe të mos jetë rehabilituar, duke treguar kështu rrezikshmëri të personit. Gjithashtu, në gjykim, përfaqësuesi i IEVP Tepelenë u shpreh se kërkuesi nuk ka përfituar nga amnistia e vitit 2015, pasi kishte për të vuajtur 13 muaj burgim, ndërkohë që amnistia përfshinte vetëm ata persona që kishin më pak se 12 muaj burgim për të vuajtur. Në rast se do konsideroheshin si dënime të kërkuesit dy vendimet e para, pa u konsideruar si i tillë vendimi i bashkimit të dënimeve, kërkuesi duhet të përfitonte nga amnistia dhe do të ishte liruar nga burgu që në fillim të vitit 2016.

44. Në analizë të shkakut të ankimit të Komisionerit Publik, në raport me prapësimet e subjektit të rivlerësimit dhe me situatën faktike të referuar si më sipër, trupi gjykues vlerësoi se arsyetimi i bërë nga ana e subjektit të rivlerësimit në vendimin nr. {***}, datë 27.12.2016, me të cilin ka vendosur lirim me kusht të të dënuarit E. Xh., në zbatim të nenit 64 të Kodit Penal, nuk është në përputhje me situatën faktike që rezultonte nga provat e administruara dhe legjislacionin e zbatueshëm. I dënuari E. Xh. është dënuar me vendimin nr. {***}, datë 23.06.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ndryshuar me vendimin nr. {***}, datë 26.11.2014, të Gjykatës së Apelit Gjyqësor Gjirokastrë, për veprën penale “Dhunë në familje”, të parashikuar nga neni 130/a, paragrafi 4 i Kodit Penal, me 1 vit burgim. Me vendimin nr. {***}, datë 19.12.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka deklaruar fajtor të pandehurin E. Xh. për veprën penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga nenet 278/2 dhe 278/3 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 8 muaj burgim. Të dyja vendimet kanë marrë formë të prerë dhe, me vendimin nr. {***}, datë 05.02.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka kryer bashkimin e dënimeve të mësipërme, duke caktuar ndaj E. Xh. një dënim të vetëm prej 13 muajsh burgim. Nga sa më sipër, rezultoi se i dënuari E. Xh. ka qenë përsëritës në krime të kryera me dashje dhe ky fakt ka qenë kusht ndalues për aplikimin e nenit 64 të Kodit Penal, i cili në kohën e gjyqimit të çështjes objekt kontrolli, parashikonte se: “Nuk lejohet lirim me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe për të dënuarin për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100”. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit në vendimin gjyqësor objekt kontrolli, se kërkuesi E. Xh. nuk konsiderohet përsëritës, pasi janë dy dënime të bashkuara në një dhe ai po kryen një dënim të vetëm të dhënë me vendim gjykate, nuk është në mbështetje të parashikimit të nenit 64 të Kodit Penal. Kërkuesi E. Xh. është dënuar për dy vepra penale të kryera me dashje, për fakte të ndryshme penale dhe në kohë të ndryshme, duke u dhënë ndaj tij dy dënime penale me vendimet përkatëse gjyqësore të formës së prerë. Fakti se atij më pas i janë bashkuar të dyja vendimet penale të mësipërme, nuk do të thotë se ai nuk është përsëritës. Fakti që këto dënime janë bashkuar në një të vetëm, nuk eliminon ekzistencën e të dyjave dënimeve dhe as faktin që i

dënuari është përsëritës për krime të kryera me dashje. Nga sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar drejt dispozitën penale materiale, nenin 64 të Kodit Penal, që rregullon institutin e lirimit me kusht. Duke qenë se i dënuari ishte përsëritës për krime të kryera me dashje, *apriori* ai ndodhej në kushtet ndaluese ligjore të paragrafit të tretë të nenit 64 të Kodit Penal, gjë që determinonte edhe zgjidhjen e çështjes në themel, për rrëzimin e kërkesës dhe duke mos lejuar që gjykata të vlerësonte më tej historikun e vuajtjes së dënimit dhe të sjelljes së të dënuarit në raport me evolucionin që ka pësuar sjellja e tij në kohën e vuajtjes së dënimit.

45. Në këto rrethana, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit demonstroi mungesë të theksuar të aftësive profesionale të gjyqtarit, lidhur me cilësinë e analizës dhe të argumentimit logjik, sipas kuptimit të nenit 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, është një pretendim i drejtë, i bazuar në prova e në ligj.

46. Lidhur me denoncimin e shoqërisë “{***}” ShA⁴², Komisioneri Publik ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit, në çështjen gjyqësore të denoncuar nga kjo shoqëri, ndodhej në kushtet dhe situatën e konfliktit të interesit, në raport me kërkesat e nenit 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9367/2005”), pika 1, shkronja “b”, “dh” dhe nënpika “v”, pasi nuk duhej të merrte pjesë në vendimmarrjen përkatëse, ku palë ndërgjyqëse ishte një shtetas me të cilin ka pasur një marrëdhënie preferenciale, juridiko-civile, apo angazhime të mëparshme miqësore.

46.1. Komisioni ka marrë në shqyrtim denoncimin e shoqërisë “{***}” ShA, e cila ka ngritur pretendime se proceset gjyqësore me objekt “Shpërblim dëmi”, kundër shoqërisë “{***}” ShA dhe persona të tretë shoqëritë e sigurimit, kanë rezultuar të gjitha jo vetëm me përgjegjësi të “{***}” ShA, edhe në ato raste kur përgjegjësia ka qenë haptazi e të dëmtuarve, por edhe vlerat e dëmshpërblimit të akorduara nga gjykatat janë në shumta marramendëse. Sipas shoqërisë denoncuese, shumat e këtyre përmasave lënë shkak për dyshime të forta për skema joligjore dhe korruptive nga të gjithë aktorët e përfshirë në këto procese. Shoqëria “{***}” ShA, ndër të tjerë, ankohet dhe për vendimin nr. {***}, datë 30.07.2018, dhënë prej subjektit të rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

46.2. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me këtë denoncim, Komisioni ka konkluduar në vendim⁴³ se: *Nga shqyrtimi i këtij denoncimi, rezulton se ankimi i përket shqyrtimit të themelit të çështjes, garant i së cilës është gjykata e shkallës më të lartë dhe, në kushte të tilla, trajtimi i këtij denoncimi nuk është në kompetencë të Komisionit. Gjithashtu, nuk janë konstatuar indicie apo të dhëna për të provuar pretendimet e denoncuesit për gjetje që do ndikonin në vlerësimin e figurës së subjektit.*

⁴² Denoncim i regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 15.10.2018.

⁴³ Paragrafi 53.3 i vendimit të Komisionit.

46.3. Komisioneri Publik, në kundërshtim të qëndrimit të mësipërm të Komisionit, ka argumentuar në ankim dhe në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, se në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër nr. {***}, datë 30.07.2018, dhënë nga subjekti si gjyqtar i vetëm, me anë të të cilit është disponuar pranimi i padisë, përfaqësues ligjor i palës paditëse në proces, në cilësinë e avokatit, ka qenë dhe z. A. D., shtetas ky me të cilin subjekti i rivlerësimit ka pasur një marrëdhënie huaje dhe interesi financiar në vitin 2012, kur subjekti i ka dhënë z. D. një hua në shumën 122.000 euro, pa interes. Në këto kushte, sipas Komisionerit Publik, në rastin e denoncimit në fjalë, Komisioni duhej të kishte vlerësuar rastin dhe në një drejtim tjetër, atë të gjykimit në kushtet e konfliktit të interesit. Komisioneri Publik, në gjendjen që janë aktet, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, në kushtet e një marrëdhënieje pasurore të provuar me shtetasin A. D., duket se ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar, në raport me kërkesat e nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005, pika 1, shkronja “b”, “dh” dhe nënpika “v”, pasi nuk duhet të merrte pjesë në vendimmarrjen përkatëse, ku palë ndërgjyqëse ishte një shtetas me të cilin ka pasur një marrëdhënie preferenciale, juridiko-civile, apo angazhime të mëparshme miqësore. Të njëjtin qëndrim, në mbështetje të shkakut të ankimit, mbajti edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në bisedimet përfundimtare në gjykimin e zhvilluar në Kolegj.

46.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në bisedimet përfundimtare, kundërshtoi pretendimin e Komisionerit Publik, duke parashtruar se që një gjyqtar të jetë në kushtet e konfliktit me palët ndërgjyqëse, me detyrimin për dorëheqje sipas parashikimit të nenit 72, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kërkohet që të jetë në një marrëdhënie kontraktore në momentin e gjykimit me ndonjë nga palët ndërgjyqëse apo dhe avokatin e palës, por jo që të ketë qenë më parë, për më tepër disa vite më parë. Sipas subjektit të rivlerësimit, për situatën e referuar nga Komisioneri Publik, ku avokati i palës paditëse ka qenë në një marrëdhënie juridike të mëpasshme me të, të përfunduar 4 vite më parë, ai, në një çështje të mëparshme në kohë, ka paraqitur kërkesë për heqje dorë te kryetari i gjykatës, i cili me të njëjtin arsyetim si më sipër, nuk e ka pranuar dorëheqjen e subjektit. Në këto kushte, ai ka qenë i detyruar për të vazhduar gjykimin e çështjes. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, ka paraqitur aktet si vijojnë:

(i) Kërkesëpadi nr. {***} akti., datë 10.06.2016, e paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër nga paditësi P. L., i përfaqësuar nga avokati A. D., kundër Byrosë Shqiptare të Sigurimit.

(ii) Kërkesë e subjektit të rivlerësimit Arben Dosti, e datës 14.06.2016, drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes civile me nr. regj. them. {***}, datë regjistrimi 13.06.2016, me palë paditëse P. L., përfaqësuar nga avokati A. D. dhe palë e paditur Byroja Shqiptare e Sigurimit, argumentuar me faktin se për shkak të ekzistencës së marrëdhënies së huasë së vitit 2012 mes tij dhe avokatit të palës paditëse A. D., marrëdhënie e cila kishte përfunduar një vit më vonë, vendimmarrja e tij në këtë rast mund të perceptohej nga publiku si jo e paanshme.

(iii) Vendim nr. {***}, datë 14.06.2016, i Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër,

sipas të cilit është vendosur deklarimi i papranueshëm i kërkesës për heqje dorë të gjyqtarit Arben Dosti nga gjykimi i çështjes civile nr. {***}, datë 13.06.2016.

47. Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi se, me vendimin nr. {***}, datë 30.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me palë paditëse B. B. etj. dhe palë e paditur shoqëria “{***}” ShA, me persona të tretë disa shoqëri sigurimesh dhe shoqërinë “{***}” ShPK, me objekt: “Shpërblim dëmi jopasuror për shkak të humbjes së jetës së familjarit D. B. [...]”, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, ka disponuar pranimin e padisë dhe detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësit në shumën totale, së paku prej 28.649.680 lekësh. Në vendimin e sipërcituar, është referuar se të gjithë paditësit u përfaqësuan në gjykim nga avokat B. K. dhe avokat A. D.. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 10.09.2019, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

47.1. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e huadhënësit, dhe z. A. D., në cilësinë e huamarrësit, kanë lidhur kontratën e huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.12.2012, me objekt dhënien e një huaje në shumën 122.000 euro, pa interes, me afat kthimi deri në datën 20.03.2013. Nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.11.2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale nga z. A. D., në lidhje me shumën prej 122.000 eurosh, objekt i kontratës së huasë së sipërcituar.

47.2. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtetasin A. D. e kam njohur kur kam punuar avokat, pasi dhe ai ushtronte profesionin e avokatit. Shuma është dhënë hua për shkak të një bashkinvestimi që do të kryente së bashku me mikun tim I. E., pasi të dy janë miq të përbashkët. Investimi nuk u krye dhe paratë u kthyen. Paratë i kam marrë cash, ashtu siç edhe i kam dhënë. Paratë i kam marrë përpara përpilimit të deklaratës noteriale për shlyerjen e detyrimit. Këto para (euro) janë depozituar në bankë dhe janë deklaruar në ILDKPKI.*

48. Në analizë të shkakut të ankimit të Komisionerit Publik dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, për të konkluduar nëse subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, në çështjen gjyqësore për të cilën ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 30.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në të cilën z. A. D. ishte përfaqësues i palës paditëse dhe gjyqfituese, trupi gjykues çmoi se vlerësimi duhet bërë bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9367/2005”, në të cilin përcaktohet rrethi i interesave pasurore dhe gjendja e konfliktit të interesit, si dhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, në të cilat parashikohen kushtet dhe procedurat se si një gjyqtar duhet ta deklarojë dhe shmangë atë.

48.1. Ligji nr. 9367/2005 përcakton në nenin 5 të tij rrethin e interesave privatë, ku, ndër të tjera, përfshihen edhe: “[...] b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; [...] dh) marrëdhënie: [...] v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë”.

Në nenin 3, shkronja “ç” e po këtij ligji, konflikti rast për rast i interesit përkufizohet si gjendja në konflikt interesi faktik, në dukje apo të mundshëm, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë. Bazuar në këtë përkufizim, si edhe në përmbajtjen e neneve 23 dhe 24 të këtij ligji, rezulton se konflikti rast për rast i interesit duhet kuptuar si një papajtueshmëri momentale ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të zyrtarit, e lidhur me një vendimmarrje të caktuar, pra, që vendimmarrja e zyrtarit të jetë e ndikuar nga interesi i tij privat, i lidhur me këtë vendimmarrje. Gjithashtu, bazuar në nenin 13 të këtij ligji⁴⁴, dispozitat që duhet të zbatohen për të përcaktuar gjendjen e konfliktit, si dhe mënyrën se si duhet zgjidhur ai, nëse ekziston për rastin konkret, duhet të jenë nenet 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile, për sa kohë që veprimtaria e zyrtarit në këtë rast, e cila pretendohet se ka qenë në një situatë konflikti interesi, lidhet me veprimtarinë procedurale të subjektit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes. Edhe neni 72 i Kodit të Procedurës Civile, i cili në pikën 3 përcakton se: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje konkrete kur: “ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve”, e lidh detyrimin e gjyqtarit me një marrëdhënie juridiko-civile, e cila është duke u zhvilluar në kohën e tashme, në momentin e gjykimit të çështjes.

48.2. Në mbështetje të legjislacionit të sipërcituar dhe rrethanave faktike të përshkruara në paragrafët më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vëren se gjatë periudhës 28.05.2018, datë në të cilën është regjistruar çështja në fjalë deri në datë 30.07.2018, datë në të cilën është dhënë vendimi nr. {***}, datë 30.07.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, nuk provohet që të ketë ekzistuar një marrëdhënie ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe z. A. D., e cila të vazhdonte të prodhonte pasoja të ndërsjella mes palëve dhe që përfaqësonte një interes privat për subjektin e rivlerësimit, interes i cili mund të konsiderohej se do të ndikonte në vendimmarrjen e tij në çështjen konkrete, apo të ishte e tillë që të cilësohej si marrëdhënie e njohur miqësie apo marrëdhënie interesi e çfarëdolloj forme, nga ato të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 9367/2005, marrëdhënie kjo që do ta vendoste atë përkundrejt detyrimit për të hequr dorë nga tagrat procedurale që kishte në çështjen konkrete, në përputhje me përcaktimin e nenit 72, pika 3 e Kodit të Procedurës Civile⁴⁵. Kontrata e huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.12.2012, me objekt dhënien e një huaje në shumën 122.000 euro, pa interes, nga subjekti i rivlerësimit te z. A. D., si dhe deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.11.2013, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale nga z. A. D., në lidhje me shumën prej 122.000 eurosh, provojnë që marrëdhënia e huasë, e lidhur mes subjektit dhe z. A. D. ka lindur në datë 20.12.2012, dhe përfunduar në datë 18.11.2013, me kthimin e shumës, pra rreth 5 vjet më parë se

⁴⁴ Në nenin 13 të ligjit nr. 9367/2005, përcaktohet se: “[...]2. Për proceset gjyqësore dhe hetimet parlamentare, identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas këtij kreu, bëhen vetëm për ato veprime, që kryhen para dhe jashtë një procesi konkret gjyqësor civil, një procedimi penal ose hetimi parlamentar. Brenda këtij procesi, identifikimi dhe regjistrimi i interesave kryhen sipas rregullave të përcaktuara, sipas rastit, në kodet e procedurave civile dhe penale, si dhe të legjislacionit që rregullon procesin e hetimit parlamentar [...]”

⁴⁵ Neni 17, pika 1, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Penale, përcakton: “[...] kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie”.

subjekti të merrte vendimin objekt kontrolli. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se nuk është provuar një papajtueshmëri momentale e subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e një vendimmarrjeje me interesin privat të tij, në kuptim të legjislacionit të zbatueshëm të analizuar më sipër në këtë vendim. Në këtë analizë, trupi gjykues çmoi të mbajë në konsideratë edhe faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar një marrëdhënie miqësie të ngushtë me z. D., si dhe ndaj subjektit të rivlerësimit nuk mund të ngrihen dyshime se ka pasur një vendimmarrje favorizuese ndaj palës paditëse gjyqfituese, e përfaqësuar në gjykim nga av. B. K. dhe av. A. D., pasi vendimi nr. {***}, datë 30.07.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 10.09.2019, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

49. Për sa më sipër, në ndryshim nga sa ka vlerësuar Komisioneri Publik, trupi gjykues arriti në përfundimin se nuk mund të konkludohet që subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, në shqyrtimin dhe marrjen e vendimit nr. {***}, datë 30.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit.

50. Për sa i përket çështjes penale me të pandehur shtetasin A. C., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal, Komisioneri Publik ka pretenduar *se të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ i këtij rasti, duhen vlerësuar nga indikatorët e përcaktuar nga neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, lidhur me cilësinë e analizës dhe të argumentimit logjik të subjektit dhe duhen konsideruar në vlerësim tërësor të çështjes, së bashku me të dhënat e tjera të rezultuara nga kriteri i vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.*

50.1. Për këtë çështje, në vendim, Komisioni⁴⁶ ka konkluduar: *Nga shqyrtimi në tërësi i çështjes së mësipërme, dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me të, si edhe provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, pa i hyrë logjikës së arsytimit dhe vlerësimit mbi vendimmarrjen që lidhet me themelin e çështjes, Komisioni çmon se ajo është bazuar në bindjen e brendshme të gjyqtarit Dosti, në verifikim dhe analizë të kriterëve mbi bazën e të cilave aplikohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe në mungesë të ndonjë kriteri të qartë ndalues. [...] Nga hetimi administrativ, rezultoi se në fashikullin hetimor është administruar certifikata elektronike e gjendjes gjyqësore e të pandehurit A. C., sipas së cilës ai figuron i padënuar. Në këtë kontekst, trupi gjykues i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit mbi vendimmarrjen e tij lidhur me këtë çështje dhe, si rrjedhim, arrin në përfundimin se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe/apo për figurën e subjektit.*

50.2. Komisioneri Publik, në kundërshtim të konkluzionit të mësipërm të Komisionit, ka argumentuar në ankim dhe në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, se të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ i këtij rasti, duhen vlerësuar nga indikatorët e përcaktuar nga neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, lidhur me cilësinë e analizës dhe të argumentimit logjik të subjektit dhe duhen konsideruar në vlerësim tërësor të çështjes, së bashku me të dhënat e tjera të rezultuara nga kriteri

⁴⁶ Paragrafi 72-72.1 i vendimit të Komisionit.

i vlerësimit profesional të subjektit. Sipas Komisionerit Publik, argumentimi i subjektit të rivlerësimit për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal në çështjen konkrete, se bima narkotike është në fazë inkubatori apo arsyetimi se veprat penale në fshehtësi nuk dihen dhe nuk ndikojnë drejtpërdrejt në rendin dhe sigurinë publike, duke mos referuar bazën përkatëse ligjore ose ndonjë jurisprudencë unifikuese, duket se tregojnë për një mangësi në cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, për më tepër në kushtet kur bëhet fjalë për veprën penale “Kultivimi i lëndëve narkotike”, gjerësisht e përhapur dhe, për këtë arsye, e një rrezikshmërie të posaçme shoqërore. Të njëjtin qëndrim, në mbështetje të shkakut të ankimit, mbajti edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare, në gjykimin e zhvilluar në Kolegj.

50.3. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse gjatë hetimit administrativ në Komision, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se i pandehuri është gjykuar në gjendje të lirë, pa masë sigurimi, duke qenë prezent në gjykim. Ky fakt ka treguar një rrezikshmëri shoqërore të ulët të këtij personi. I pandehuri ka qenë i padënuar më parë. Ky fakt merret në konsideratë nga gjykata, pasi provon rrezikshmërinë e ulët të të pandehurit. Fakti kriminal ka ndodhur në vitin 2015. Sipas subjektit të rivlerësimit, ai ka mbajtur në konsideratë faktin se në vitet 2015 – 2016, ka pasur rritje të aktivitetit kriminal të kultivimit të bimëve narkotike. Në qarkun e Gjirokastrës, ky aktivitet është vërejtur nga numri i procedimeve të ardhura për këto çështje, apo me kapjen e sasive shumë të mëdha të bimës *cannabis sativa*, deri në tonelata. Është konstatuar fakti se shumica e kanë kryer këtë aktivitet për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike në familjet e tyre. Në ato raste kur personi nuk ka qenë përsëritës, si rregull, për këta persona, është aplikuar neni 59 i Kodit Penal, pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim. Subjekti i rivlerësimit ka referuar se i pandehuri, në kohën e gjykimit, ka qenë në moshë të re. Në familje jetonte me prindërit e tij, të dy pensionistë. Burgosja e të pandehurit mund të shkaktonte cenim të gjendjes shëndetësore, shpirtërore të këtyre personave. Në çdo kohë i pandehuri mund të fillonte punë për krijimin e të ardhurave për vete dhe për prindërit e tij. Gjykata e Apelit, në vendim, shprehet se rrezikshmëria e të pandehurit është e lartë, për shkak të sasisë së bimëve narkotike të kultivuara. Në vendimmarrjen e tij, subjekti ka marrë në konsideratë edhe fazën në të cilën ndodheshin këto bimë narkotike. Këto bimë ende nuk ishin të mbjella. Ato ndodheshin në fazën inkubatore dhe, deri në ato momente, nuk plotësonin asnjë kriter për t’u konsideruar të përdorshme dhe të rrezikshme për shëndetin e njerëzve. Deri në arritjen e kohës për vjeljen e tyre, do të kalonin disa faza dhe një periudhë e gjatë kohore, me mundësinë e të pandehurit për të hequr dhe dorë nga vepra penale ose që i pandehuri të dështonte në kultivimin e tyre. Koha dhe gjendja e bimëve narkotike të kultivuara merret në konsideratë nga gjykata në masën e dënimit dhe aplikimin e pezullimit të dënimit. Në dispozitën penale dënohet si ai që posedon fara të bimëve narkotike, ashtu dhe ai që kultivon ose posedon lëndë narkotike. Por këto forma të anës objektive të veprës penale nuk janë të njëjta në përcaktimin e rrezikshmërisë së personit që i posedon ato. Vepra penale e kultivimit të bimëve narkotike është kryer në fshehtësi. Sipas subjektit, ka një diferencë midis veprave penale të kryera në publik dhe atyre të kryera në fshehtësi. Dallimi është te fakti që veprat penale në fshehtësi, nuk dihen dhe nuk ndikojnë drejtpërdrejt në rendin dhe

sigurinë publike. I pandehuri C. e ka kryer veprën penale në fshehtësi, në banesën e tij, pa ndikuar drejtpërdrejt në rendin dhe sigurinë e komunitetit ku banon.

51. Nga aktet e administruara gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

51.1. Me vendimin nr. {***}, datë 29.03.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e përbërë nga subjekti i rivlerësimit si gjyqtar i vetëm, ka vendosur deklarinimin fajtor të pandehurit A. C., për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal dhe dënimin me 3 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimit të mësipërm i zbritet një e treta, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin me 2 vjet burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit, duke e vendosur në provë të pandehurin A. C. për një periudhë prej 2 vjetësh, me kusht që gjatë kësaj periudhe prove të mos kryejë veprë tjetër penale, si dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, Gjirokastrë.

51.1.1. Në arsyetimin e vendimit nr. {***}, datë 29.03.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në parashtrimin e rrethanave të faktit, subjekti i rivlerësimit ka referuar se në datë 18.06.2015, në banesën e z. A. C., në Gjirokastrë, nga kontrolli i kryer nga organet e policisë, në oborrin e banesës së tij janë gjetur të mbjella bimë të dyshuara si narkotike, të llojit *cannabis sativa*, me ngjyrë jeshile, me lartësi nga 5-30 cm. Këto bimë ishin të mbjella në kubikë e qese plastike me ngjyrë të zezë. Numri total i bimëve ishte 466 rrënjë, të cilat u sekuestruan dhe 30 prej tyre u morën në cilësinë e provës materiale. I pyetur mbi faktet e mësipërme, i pandehuri ka pranuar faktin e mbjelljes së bimëve narkotike. Sipas aktit të ekspertimit kimik të bimëve me nr. {***}, datë 14.06.2016, rezultoi se bimët objekt ekspertimi janë *cannabis sativa L*, në fazën e rritjes. Në këto rrethana, prokuroria ka dërguar për gjykim të pandehurin A. C. (djali i z. A. C.), akuzuar për veprën penale të kultivimit të bimëve narkotike, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal. Lidhur me aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar: “[...] i pandehuri është hetuar dhe gjykuar në gjendje të lirë, pa masë sigurimi personal. Sipas akteve të paraqitura nga mbrojtja në gjykim, rezulton se familja e të pandehurit përbëhet nga prindërit e tij dhe i pandehuri. Prindërit e të pandehurit janë në moshë relativisht të madhe, të rënduar nga ana shëndetësore dhe aktualisht janë pensionistë dhe vetëm i pandehuri është në gjendje pune për të mbajtur ekonomikisht familjen e tij. I pandehuri ka një moshë relativisht të re, si dhe bimët narkotike të mbjella ishin akoma në fazën e inkubatorit, të pambjella në terren, duke ekzistuar mundësia që i pandehuri të hiqte dorë nga vepra penale. Sa më sipër, gjykata vlerëson se plotësohen kriteret e kërkuara nga ligji për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal dhe do të disponojë me pranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të dënimit penal, duke e vendosur të pandehurin në provë për një kohë prej 2 vjetësh. Në përfundim, gjykata çmon se dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale, rrethanat, vendin e kryerjes dhe rrezikshmërinë e autorit. Gjithashtu, dënimi i dhënë do t’i shërbejë të pandehurit për edukimin e tij, parandalimin e kryerjes

së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimin e tij, si dhe parandalimin e përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri”.

51.1.2. Mbi ankimin e prokurorit vetëm për sa i takon aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal, Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 29.07.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër në lidhje me fajësinë e masën e dënimit për të pandehurin dhe ndryshimin e vendimit sa i përket mënyrës së vuajtjes së dënimit prej tij, duke u vendosur mosaplikimi i nenit 59 të Kodit Penal. Gjykata e Apelit Gjirokastër ka vlerësuar se nuk duhet të aplikohet neni 59 i Kodit Penal, duke arsyetuar: “[...] kriteri bazë i aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal është rrezikshmëria e pakët e personit dhe plotësimi i disa kushteve të tjera, siç është mosha, kushtet shëndetësore etj. Nga studimi i rrethanave të ngjarjes, rezulton se sasia e bimëve narkotike të mbjella nga i pandehuri, është relativisht e lartë, gjë e cila flet për rrezikshmëri jo të pakët të të pandehurit A. C.. Fakti që prindërit e të pandehurit janë pensionistë, nuk justifikon aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal. Gjithashtu, nuk provohet që i pandehuri është i punësuar e, për rrjedhojë, që me këto të ardhura, mban familjen. Sa më sipër, Gjykata e Apelit, bazuar edhe në faktin që kjo vepër penale është shumë e përhapur e është bërë fenomen shqetësues si kombëtar, edhe ndërkombëtar, çmon se vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të ndryshohet vetëm për sa i përket aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal, duke u vendosur mosaplikimi i nenit 59 të Kodit Penal”.

51.1.3. Nga verifikimi i burimeve zyrtare të hapura, konkretisht nga verifikimi i publikimeve në faqen zyrtare në internet të Gjykatës së Lartë, rezultoi se kjo gjykatë ka shqyrtuar rekursin e paraqitur nga kërkuesi A. C. dhe Kolegji Penal, me vendimin nr. {***}, datë 23.03.2023, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i gjykuari A. C., kundër vendimit nr. {***}, datë 27.09.2017, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër”, duke arsyetuar: *Në referim të rekursit të paraqitur nga i gjykuari, Kolegji vlerëson se pretendimi i të gjykuarit për zbatim të gabuar të kriterëve në lidhje me moszbatimin e alternativës së dënimit me burgim, pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë sipas nenit 59 të Kodit Penal, si element i zbatimit të ligjit penal material, është i pabazuar në ligj. Neni 59 i Kodit Penal përcakton kriteret ligjore për zbatimin e këtij dënimi alternativ, duke parashikuar se: “Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit”.* Në interpretim të dispozitës së cituar më lart, rezulton se, në caktimin e këtij dënimi alternativ, gjykata duhet të verifikojë plotësimin e disa kushteve. Së pari, masa e dënimit të caktuar të jetë deri në pesë vjet dhe, së dyti, të ekzistojnë një ose disa nga këto kushte; rrezikshmëria e paktë e personit, mosha, kushtet shëndetësore apo mendore, mënyra e jetesës dhe nevojat, veçanërisht ato që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe të sjellja pas kryerjes së veprës penale. Tërësia e këtyre kushteve verifikohet nga gjykata në caktimin e dënimit alternativ dhe ky dënim caktohet gjithmonë në ato

raste kur gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të realizojë funksionin rehabilitues të përgjithshëm dhe të posaçëm në drejtim të të pandehurit. Në zbatim të parashikimeve të mësipërme, Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit Gjyrokastër ka interpretuar drejt kriteret e përcaktuara në nenin 59 të Kodit Penal, duke argumentuar vendimmarrjen e saj.

52. Në analizë të shkakut të ankimit, trupi gjykues vëren se pretendimi i Komisionerit Publik u referohet argumenteve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në vendimin nr. {***}, datë 29.03.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, lidhur me aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, se i pandehuri kishte rrezikshmëri të ulët, pasi *bimët narkotike të mbjella ishin akoma në fazën e inkubatorit, të pambjella në terren, duke ekzistuar mundësia që i pandehuri të hiqte dorë nga vepra penale*, si dhe argumenteve të cilat janë dhënë nga subjekti në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, se *vepra penale e kultivimit të bimëve narkotike është kryer në fshehtësi. Ka një diferencë midis veprave penale të kryera në publik dhe atyre të kryera në fshehtësi. Dallimi është te fakti që veprat penale në fshehtësi, nuk dihen dhe nuk ndikojnë drejtpërdrejt në rendin dhe sigurinë publike. I pandehuri C. e ka kryer veprën penale në fshehtësi, në banesën e tij, pa ndikuar drejtpërdrejt në rendin dhe sigurinë e komunitetit ku banon.*

52.1. Sa më sipër, trupi gjykues vëren se në argumentimin e rrezikshmërisë së ulët shoqërore të të pandehurit e, për pasojë, aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit është bazuar në fazën në të cilat ndodheshin bimët narkotike që përbënin objektin e veprës penale, ndërkohë që neni 284/1 i Kodit Penal inkriminon veprimin e kultivimit të bimëve që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope, pa leje dhe autorizim sipas ligjit, duke nënkuptuar se si elemente të anës objektive të kësaj vepre penale janë të gjitha veprimet e nevojshme që nga posedimi i farave, mbjellja e deri te vjelja e bimëve narkotike. Trupi gjykues, në të njëjtën linjë me ankimin e Komisionerit Publik dhe Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, konstatoi se aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal, me argumentimin se: *bima narkotike është në fazë inkubatori apo arsyetimi se veprat penale në fshehtësi nuk dihen dhe nuk ndikojnë drejtpërdrejt në rendin dhe sigurinë publike*, pa referuar bazën përkatëse ligjore ose jurisprudencë unifikuese, dëshmon për mangësi në kuptimin e interpretimin e ligjit penal material, si dhe në cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik. Në vlerësimin e këtyre argumenteve të subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, u mbajt në konsideratë që në kushtet kur bëhej fjalë për veprën penale të “Kultivimit të lëndëve narkotike”, gjerësisht e përhapur në atë periudhë dhe, për këtë arsye, e një rrezikshmërie të posaçme shoqërore, arsyetimi i subjektit të rivlerësimit në vendimin objekt kontrolli, konsiderohet me mangësi në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nënindikatorëve të përcaktuar nga neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

52.2. Vendimi nr. {***}, datë 10.05.2023, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të cilin është vendosur deklarimi fajtor për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1, paragrafi 2 i Kodit Penal, i të pandehurit Sh. M., ish-avokat i të pandehurit A. C. në çështjen objekt kontrolli, depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit

në Kolegj, u gjet nga trupi gjykues pa relevancë në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronjat “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, pasi fakti se ish-avokati i të pandehurit A. C. është dënuar me vendimin penal përkatës, për ushtrim ndikimi të paligjshëm ndaj subjektit të rivlerësimit për një çështje tjetër gjyqësore (të ndryshme nga çështja objekt kontrolli), nuk sjell asnjë argument në favor të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit.

53. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit evidenton mangësi në aspektin e arsytetit ligjor në treguesin e analizës dhe të argumentimit logjik, në kuptim të nenit 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016 e, për rrjedhojë, shkak i ankimit të Komisionerit Publik është i drejtë dhe i bazuar në ligj.
54. Sa i përket një informacioni të përftuar nga burime të hapura (mediet elektronike), sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka vendosur masën e sigurimit personal “arrest shtëpie” për shtetasin P. N., për të cilin raportohet se është arrestuar në flagrancë me 58 kg lëndë narkotike të llojit *cannabis sativa*, Komisioneri Publik ka pretenduar se *të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ i rastit, lidhur me cilësinë e analizës dhe të argumentimit logjik të subjektit, duhen vlerësuar nga indikatorët e përcaktuar nga neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016 dhe, si të tilla, duhen parë në vlerësim tërësor të çështjes, së bashku me të dhënat e tjera të rezultuara nga kriteri i vlerësimit profesional të subjektit.*

54.1. Për këtë çështje, në vendim⁴⁷, Komisioni ka konkluduar: *Nga shqyrtimi në tërësi i çështjes së mësipërme, dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me të, si edhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, pa i hyrë logjikës së arsytimit dhe vlerësimit mbi vendimmarrjen që lidhet me themelin e çështjes, Komisioni çmon se edhe në këtë rast, ajo është bazuar në bindjen e brendshme të gjyqtarit Dosti, në verifikim dhe analizë të kushteve/kritereve të përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara nga legjislacioni penal për caktimin e masës së sigurimit personal dhe llojit të saj. Në këtë kontekst, trupi gjykues vlerëson se duken bindëse shpjegimet e subjektit mbi vendimmarrjen e tij lidhur me këtë çështje dhe, si rrjedhim, arrin në përfundimin se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe/apo për figurën e subjektit.*

54.2. Në kundërshtim të këtij konkluzioni, Komisioneri Publik ka argumentuar në ankim dhe në parashtrime gjatë gjykimit në Kolegj, se Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 07.07.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit sa i përket disponimit për caktimin e masës së sigurimit, duke dhënë masën e “Arrestit me burg”, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Apelit ka vlerësuar ndryshe lidhur me elementet: (i) e rrezikut të ikjes; (ii) e mundësisë që personi nën hetim të ndërhyjë në procesin e drejtësisë; dhe (iii) përshtatshmërisë së masës së sigurimit në raport me sanksionin penal të parashikuar për veprën penale, të cilën ky person dyshohet të kishte kryer. Komisioneri Publik ka vlerësuar se të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ i rastit, lidhur me cilësinë e analizës dhe të argumentimit logjik

⁴⁷ Paragrafi 75 i vendimit të Komisionit.

të subjektit, duhen vlerësuar nga indikatorët e përcaktuar nga neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016 dhe, si të tilla, duhen parë në vlerësim tërësor të çështjes, së bashku me të dhënat e tjera të rezultuara nga kriteri i vlerësimit profesional të subjektit. Të njëjtin qëndrim, në mbështetje të shkakut të ankimit, mbajti edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në bisedimet përfundimtare në gjykimin e zhvilluar në Kolegj.

54.3. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjyimit në Kolegj, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse gjatë hetimit administrativ në Komision, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se i qëndron arsytimit të bërë prej tij në vendimin objekt kontrolli. Lidhur me vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kur çështja shkon për gjykim në Gjykatën e Apelit, kjo gjykatë nuk mund të ecë me aludime ligjore. Nëse gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur arrest në burg, por një nga masat e tjera shtrënguese dhe personi me masë sigurimi ka qenë korrekt në ekzekutimin e masës, si dhe gjatë gjyimit në Apel paraqitet personalisht, atëherë, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk ka vend për aludime se personi mund të ikë dhe t'i shmanget drejtësisë. Sipas subjektit, kryerja e ekspertimeve biologjike dhe kompjuterike kryhet nga policia gjyqësore dhe, në to, nuk mund të ndërhyjë një person nën akuzë, i izoluar elektronikisht në shtëpi. Gjithashtu, personat nën hetim kanë të drejtë të mos deklarojnë dhe nuk mund të penalizohen për këtë fakt. Personi nën hetim P. N. ka qenë i padënuar më parë, me arsim të lartë, i martuar, me dy fëmijë të mitur, si dhe nëna e tij vuante nga invaliditeti i plotë. Këto rrethana gjyqësore të personit nën hetim janë mbajtur në konsideratë prej tij në caktimin e masës së sigurimit. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimi i dhënë prej tij është në përputhje me rëndësinë e faktit, rrezikshmërinë e personave, si dhe në zbatim të drejtë të ligjit procedural penal.

- 55.** Referuar akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe akteve të administruara gjatë gjyimit në Kolegj, trupi gjykues vëren se mbi kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest me burg” për personin nën hetim P. N., dyshuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, i arrestuar në flagrancë për shkak se gjatë një kontrolli të policisë, në automjet i janë gjetur rreth 58 kg lëndë e dyshuar narkotike e llojit *cannabis sativa*, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, me vendimin nr. {***}, datë 20.06.2017, ka vendosur vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi, me mbikëqyrje elektronike” për personin nën hetim, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale dhe ligji nr. 10496/2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”. Në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka arsyetuar: *Gjykata vëren se masa e sigurimit nuk është masë ndëshkimore për personin që dyshohet se ka kryer një vepër penale dhe, nga ana tjetër, nuk jepet për të lehtësuar punën e organit të prokurorisë në hetimin e çështjes penale, por ajo duhet të aplikohet vetëm në zbatim të shkaqeve, kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në mënyrë të qartë në nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale. Për më tepër, masa e sigurimit personal nuk njehsohet me dënimin penal, pasi është një veprim procedural që kufizon përkohësisht lirinë e personit ndaj të cilit po zhvillohet procedimi penal. Ky kufizim është i*

*përkohshëm dhe shkalla e tij varet nga nevoja konkrete të procesit të hetimit (Gjykata e Lartë, vendimi nr. {***}, datë 25.06.2015). [...] Ky trup gjykues mban në konsideratë që, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal, GjEDNJ-ja ka evidentuar tri arsye të tjera të rëndësishme që lejojnë mbajtjen e një personi në paraburgim. Këto arsye janë: 1) rreziku që personi të largohet; 2) rreziku i ndërhyrjes në procesin e drejtësisë; 3) domosdoshmëria për të parandaluar një krim tjetër dhe për të ruajtur rendin publik. Sipas GjEDNJ-së, kufizimet ndaj së drejtës për liri duhet të shihen si të jashtëzakonshme dhe duhen lejuar vetëm kur vendimi i gjykatës jep një justifikim bindës. (Gjykata e Lartë, vendimi nr. {***}, datë 25.06.2015). Arsyet e mësipërme, që të justifikojnë paraburgimin, nuk kërkohet që të ekzistojnë njëkohësisht, pra janë alternative dhe do të mbahen parasysht nga ky trup gjykues dhe konkretisht: [...] Për rastin në shqyrtim, gjykata çmon se nuk u provua në gjykim se ekziston rreziku i ikjes së personit nën hetim. Nga organi i akuzës nuk u paraqit asnjë provë për të provuar faktin e pretenduar prej tyre për rrezik të ikjes së personit nën hetim nga procedimi penal. Rrezikshmëria e ikjes u pretendua vetëm për shkak të masës së rëndë të dënimit që parashikon vepra penale e dyshuar se është kryer nga personi nën hetim, pa analizuar rrezikshmërinë e autorit të dyshuar apo ekzistencën e rrethanave rënduese apo lehtësuese, sipas nenit 229/2 të Kodit të Procedurës Penale. [...] nuk ekziston asnjë provë apo mundësi reale që personi nën hetim të ketë mundësi të ndërhyjë në procesin e drejtësisë, pasi veprimet procedurale në vendin e ngjarjes kanë përfunduar dhe nuk u paraqit asnjë provë apo pretendim që personi nën hetim të paraqesë rrezikshmëri për cenim të marrjes së provave apo të vërtetësisë së tyre, konkretisht të akteve të ekspertimit të cilat kryhen në Institutin e Policisë Shkencore, Tiranë. [...] Rezultoi e provuar në çështjen në gjykim se personi nën hetim është i padënuar më parë penalisht, është me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar dhe baba i dy fëmijëve të mitur, nëna e tij është invalide, rrethana që krijojnë dyshimin se kjo ngjarje mund të jetë episod i shkëputur në jetën e tij. Vepra penale për të cilën dyshohet të jetë kryer prej tij, nuk paraqet koneksitet me rrethana apo fakte dyshuese, që të krijojnë dyshimin e mundësisë së kryerjes së veprave penale nga personi nën hetim. Gjykata vlerëson se prokuroria, në kërkesën për caktimin e masës shtrënguese “Arrest në burg”, nuk ka bërë asnjë analizë të shkaqeve se përse çdo lloj mase tjetër është e papërshtatshme. [...] Vetëm pretendimi se personi nën hetim dyshohet për kryerjen e veprës penale, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, dhe se kjo dispozitë parashikon masa të larta dënimi me burgim, nuk janë arsye të forta dhe të mjaftueshme që personi nën hetim të hetohet në gjendje paraburgimi.*

55.1. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 07.07.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër sa i përket disponimit për vleftësimin “Arrest në flagrancë” ndaj personit nën hetim P. N. dhe ndryshimin e këtij vendimi sa i përket disponimit për caktimin e masës së sigurimit, duke i caktuar masën e sigurimit “Arrest me burg”, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale. Në vendimin e saj, Gjykata e Apelit Gjirokastër ka arsyetuar se: *Ndryshe nga sa ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë, gjykata e Apelit vlerëson se në rastin në shqyrtim, ekziston rreziku i ikjes dhe, ndryshe nga sa arsyeton gjykata e shkallës së parë, rreziku i largimit, referuar vendimit unifikues nr. 7, datë 14.10.2011, të Kolegjeve të*

Bashkuara të Gjykatës së Lartë, krahas elementeve të tjera, mund të lidhet e të rezultojë edhe nga vetë natyra e akuzave në ngarkim të të gjykuarit, nga rëndësia e faktit, e sanksionit për veprën penale dhe lloji e shkallës së pasojave të ardhura prej saj. Në rastin në shqyrtim, sanksioni që parashikon akuza, e cila dyshohet të ngrihet në ngarkim të personit nën hetim P. N., burgim nga 7-15 vjet, është një arsye serioze për të dyshuar mbi mundësinë apo përgatitjen reale dhe efektive të ikjes, nëse nuk ndërhyhet për ta izoluar personin nën hetim. [...] I pabazuar vlerësohet arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se nuk ekziston një provë apo mundësi reale që personi në hetim të ketë mundësi të ndërhyjë në procesin e drejtësisë. Vlen të theksohet se veprime të tjera hetimore janë për t'u kryer në këtë çështje penale [...] dhe, referuar faktit që personi nën hetim ende nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me ngjarjen, ende nuk janë përfunduar ekspertimet biokimike dhe kompjuterike, janë arsye të cilat çojnë gjykatën e apelit në bindjen se ekziston dyshimi i bazuar në prova se personi nën hetim, nëse lihet i lirë, do të rrezikojë provat dhe procesin e të provuarit, sikurse janë: kërkimi, marrja, vërtetësia dhe ruajtja e provës e të burimeve të provës. [...] Gjykata e apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar përshtatshmërinë e masës së sigurimit, sipas nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale. Masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” nuk i përgjigjet rëndësisë së faktit dhe sanksionit penal të parashikuar për veprën penale të cilën ai dyshohet të ketë kryer.

55.2. Me vendimin nr. {***}, datë 22.01.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka vendosur: *Deklarimin fajtor të të pandehurit P. N. për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” dhe, bazuar në nenin 283/1, 48/c dhe 49 të Kodit Penal, dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit në 1/3 dhe dënimin përfundimisht të të pandehurit P. N. me tre vjet e katër muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e mbetur të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurit në provë për një periudhë prej 2 vjet e gjashtë muaj. Në aplikim të nenit 60 e vijues të Kodit Penal, urdhërohet i pandehuri të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe të mos shoqërohet me persona të dënuar. Shuarjen e masës së sigurimit “Arrest në burg”, dhënë me vendim gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë [...]. Në këtë vendim, Gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar: Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, gjykata, për shkak të rrezikshmërisë së ulët të personit, pendesës së thellë, lëndës narkotike të sekuestruar, moshës së tij në kohën e kryerjes së veprës, është prind me dy fëmijë të mitur, çmon pezullimin e dënimit me burgim për kohën e mbetur.*

- 56.** Në analizë të shkakut të ankimit të Komisionerit Publik, në raport me prapësimet e subjektit të rivlerësimit dhe situatën faktike të pasqyruar në paragrafin më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në arsyetimin e vendimit për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, me mbikëqyrje elektronike për personin nën hetim P. N., ka analizuar të gjitha elementet e indikuara nga neni 228, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, për vendosjen e masës së sigurimit personal, të cilat janë evidentuar edhe në vendimin unifikues penal të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 14.10.2011, si kushte dhe kritere alternative dhe jo kumulative, të cilat do të duhet të vlerësohen rast pas rasti. Sipas Kolegjeve të Bashkuara, nëse në

gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mosekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që, sipas ligjit, justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të gjykuarit.

57. Nga kontrolli i vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se ai ka zbatuar normën procedurale penale, tregues që lidhet me nivelin e cilësisë së analizës e argumentimit logjik, sipas kuptimit të nenit 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

Në këtë analizë, përpos sa më sipër, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe se përcaktimi nëse bindja e brendshme e subjektit të rivlerësimit në vlerësimin e provave dhe rrethanave konkrete në raport me legjislacionin e zbatueshëm, ka qenë e duhura apo jo, del jashtë kompetencave të organeve të rivlerësimit, për sa kohë lidhet drejtpërdrejt me korrektësinë e vendimmarrjes, pra me atë aspekt të aftësive profesionale të magistratëve që nuk mund të gjykohet e të shërbejë si matës i aftësive të tyre profesionale në kuadër të këtij procesi, sipas parashikimit të nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

58. Komisioneri Publik ka pretenduar në ankim, se *të dhënat që përmban raporti i vlerësimit profesional të hartuar nga KLGj-ja, duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, në referim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe/ose të trajtohen në vlerësimin tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

58.1. Komisioni, në vendim⁴⁸, ka konkluduar se: *Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të ish-KLD-së. Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënave nga burimet arkivore, si edhe në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit për gjetjet e listuara në këtë raport, Komisioni çmon se nuk konstatohen problematika thelbësore lidhur me vlerësimin e kriterit profesional.*

58.2. Në kundërshtim të këtij konkluzioni, Komisioneri Publik ka argumentuar në ankim dhe në parashtrime gjatë gjykimit në Kolegj, se ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, gjetjet e analizuara nga raporti i vlerësimit profesional të hartuar nga KLGj-ja, duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit. Të njëjtin qëndrim, në mbështetje të shkakut të ankimit, mbajti edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare, në gjykimin e zhvilluar në Kolegj. Subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, parashtrroi të njëjtat argumente, në prapësimin e shkakut të ankimit, sikurse gjatë hetimit administrativ të zhvilluar në Komision, lidhur me gjetjet e raportit të KLGj-së.

⁴⁸ Paragrafi 45.1 – 45.2 i vendimit të Komisionit.

59. Trupi gjykues analizoi gjetjet e sipërcituara, të referuara nga Komisioneri Publik në ankim, si në vijim.
60. Lidhur me gjetjen e raportit të vlerësimit profesional të hartuar nga KLGj-ja, mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale në aspektin e njohurive ligjore se, *në një rast është konstatuar se gjyqtari nuk ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e procesit në mungesë të palës së paditur*⁴⁹, konstatohet se në çështjen civile nr. {***} regj., datë 27.03.2014, që iu përket palëve ndërgjyqëse: paditës shoqëria “{***}” ShPK dhe të paditur shoqëria “{***}” ShPK, me objekt “Përmbushje detyrimi”⁵⁰, subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 26.06.2014, me të cilin ka vendosur pranimin e padisë dhe lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.

60.1. Nga verifikimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore për çështjen objekt kontrolli, trupi gjykues konstatoi se: Në seancën përgatitore të datës 15.04.2014, nuk është paraqitur pala e paditur, e cila nuk rezultoi të ketë marrë njoftim, pasi në fletëthirrjen e kthyer ishte vendosur shënimi: “Larguar”. Në seancën e dytë përgatitore, datë 22.04.2014, subjekti i rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur të ripërsëritë njoftimin për palën e paditur, pasi pala paditëse ka plotësuar të metën e konstatuar në seancën e mëparshme përgatitore lidhur me adresën e palës së paditur. Në seancën e tretë përgatitore, datë 12.05.2014, pala e paditur nuk është paraqitur, pasi njoftimet e nisura në të dyja adresat e saj, janë kthyer nga shërbimi postar. Subjekti i rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur për njoftimin e të paditurit me shpallje, bazuar në nenin 133 të Kodit të Procedurës Civile. Pala e paditur nuk është paraqitur as në seancën e katërt përgatitore të datës 05.06.2014. Subjekti i rivlerësimit, pa marrë vendim për zhvillimin e seancës përgatitore, në mungesë të palës së paditur, ka vendosur të çelë hetimin gjyqësor duke ftuar palën paditëse të parashtrojë shpjegimet dhe provat mbi të cilat mbështeste padinë e ngritur prej saj. Në seancën gjyqësore të datës 26.06.2014, e cila në procesverbal është shënuar si seancë përgatitore, pala e paditur nuk është paraqitur, megjithëse është njoftuar rregullisht me shpallje. Subjekti i rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm ka deklaruar shpalljen e trupit gjykues dhe, me vendim tjetër të ndërmjetëm, ka deklaruar të hapur hetimin gjyqësor, pa marrë më parë vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur. Në këtë seancë, i është dhënë fund hetimit gjyqësor dhe subjekti i rivlerësimit ka shpallur dhe vendimin, duke disponuar për pranimin e padisë.

60.2. Gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, lidhur me gjetjen e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se praktika gjyqësore, më parë dhe sot, ka ecur në drejtimin që në seancën përgatitore, gjykata verifikon paraqitjen e palëve, por nuk merr vendim për zhvillimin e gjykimit në mungesë, pasi në këtë fazë nuk është hyrë ende në fazën e gjykimit të çështjes. Vendimi për gjykimin në mungesë, merret në fazën e gjykimit të çështjes dhe jo në fazën përgatitore të tij. Sipas subjektit të rivlerësimit, fakti i konstatuar nga raporti i KLGj-së, nuk ka shkelur asnjë nga të drejtat e palëve ndërgjyqëse në procesin civil.

⁴⁹ Faqja 36 e raportit të KLGj-së.

⁵⁰ Dosja 5 në raportin e vlerësimit profesional të KLGj-së.

60.3. Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik, i konfirmuar edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në raport me situatën e rezultuar nga hetimi administrativ i Komisionit, trupi gjykues vëren se, në ndryshim nga sa ka argumentuar subjekti i rivlerësimit në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, gjetja e raportit të KLGj-së i referohet vendimit të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur, evidentimi i të cilit është i nevojshëm për të dalluar situatën procedurale të vendosjes nga gjykata të zhvillimit të gjykimit në mungesë të të paditurit, sipas parashikimit të paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile⁵¹, si dhe në përmbushje të parashikimit të nenit 125 të këtij Kodi, sipas të cilit: *Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancë gjyqësore, me qëllim që t'i përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi.* Gjithashtu, referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në Komision se, *në seancë përgatitore, gjykata verifikon paraqitjen e palëve, por nuk merr vendim për zhvillimin e gjykimit në mungesë, pasi në këtë fazë nuk kemi hyrë ende në fazën e gjykimit të çështjes, por jemi ende në fazën përgatitore*, trupi gjykues vëren se ai ka përfunduar shqyrtimin e çështjes dhe ka dhënë vendimin, duke u gjendur ende në fazën përgatitore të gjykimit të çështjes, situatë kjo që vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 170 të Kodit të Procedurës Civile.

61. Lidhur me gjetjen e raportit të vlerësimit profesional të hartuar nga KLGj-ja, mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale në aspektin e njohurive ligjore se, *në dy raste është vërejtur se në vendimin përfundimtar gjyqtari, nuk ka përcaktuar palën të cilit i ngarkohen shpenzimet gjyqësore*⁵², trupi gjykues konstatoi se në njërin nga tri dokumentet ligjore të paraqitura, konkretisht në vendimin civil nr. {***}, datë 21.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me palë paditëse A. Z. dhe palë të paditur A. Z., me objekt zgjidhje martese etj., në dispozitiv, lidhur me shpenzimet gjyqësore, subjekti i rivlerësimit ka disponuar: *Shpenzimet gjyqësore, siç janë bërë.* Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka përcaktuar masën e këtyre shpenzimeve dhe as palën së cilës i ngarkohet pagesa e tyre, ashtu siç parashikonte neni 106, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: “Taksat mbi aktet, shpenzimet e tjera gjyqësore dhe shpërblimi për një avokat, në qoftë se ka pasur të tillë, të paguara nga paditësi, i ngarkohen të paditurit në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata. Taksa mbi aktet dhe shpenzimet e tjera gjyqësore, nga pagimi i të cilave pala është përjashtuar sipas nenit 105/b, i ngarkohen palës tjetër në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata”. E njëjta mangësi u konstatua nga trupi gjykues edhe në vendimin nr. {***}, datë 28.07.2016, me palë paditëse R. M. dhe palë të paditur M. M., me objekt “Zgjidhje martese”, që i

⁵¹ Neni 179 i Kodit të Procedurës Civile, me titull “Pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve”, në paragrafët 2 dhe 3 parashikon: “[...] Nëse i padituri nuk paraqitet në seancën e parë dhe paditësi nuk kërkon që gjykimi të zhvillohet në mungesë, gjykata cakton një seancë tjetër gjyqësore.

Nëse ky nuk paraqitet edhe në seancën tjetër gjyqësore dhe paditësi nuk kërkon që gjykimi të zhvillohet në mungesë, gjykata vendos pushimin e gjykimit”.

⁵² Faqja 36 e raportit të KLGj-së.

përket dosjes nr. {***}, të përzgjedhur me short. Kjo gjetje është evidentuar në raportin e KLGj-së edhe në analizën për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale në aspektin e arsyetimit ligjor.

62. Lidhur me gjetjen e raportit të vlerësimit profesional të hartuar nga KLGj-ja, mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale në aspektin e njohurive ligjore, *se në dy raste gjyqtari nuk ka disponuar për heqjen e masës së sigurimit të caktuar ndaj të pandehurit, në kundërshtim me detyrimin e parashikuar në nenin 389 të K. Pr. Penale*⁵³, trupi gjykues konstatoi se në njërin nga tri dokumentet ligjore të paraqitura, konkretisht në vendimin penal nr. {***}, datë 24.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, që i përket të pandehurit A. G., i akuzuar për veprën penale “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit ka vendosur deklarin e pafajshëm të të pandehurit. Në dispozitivin e këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit nuk është shprehur për heqjen e masës së sigurimit të caktuar ndaj të pandehurit, në kushtet kur ai u deklarua i pafajshëm. E njëjta situatë u konstatua nga trupi gjykues edhe në dosjen nr. {***} të përzgjedhur me short, konkretisht në vendimin penal nr. {***}, datë 13.03.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket të pandehurit H. K., i akuzuar për veprën penale “Vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, në dispozitivin e të cilit është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit për veprën penale, duke e dënuar përfundimisht me 4 muaj burg, dënim i cili është pezulluar duke e vendosur të pandehurin në provë prej 2 vjetësh. Në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit nuk është shprehur për heqjen e masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, të caktuar më parë ndaj të pandehurit me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 03.12.2013.

62.1. Gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, lidhur me gjetjet e sipërcituara, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se mungesa e shprehjes në dispozitiv lidhur me masën e sigurimit, ka ardhur vetëm për shkak harrese dhe ka ndodhur në fillimet e ushtrimit të funksioneve të tij si gjyqtar, në një vendim të dhënë gjatë kohës së kryerjes së stazhit në Shkollën e Magjistraturës dhe në një tjetër të dhënë dy muaj pas fillimit të detyrës. Kjo harresë nuk ka favorizuar asnjë palë, pasi masa e sigurimit shuhet automatikisht nëse gjykata disponon me vendim pafajësie ose pushimi çështjeje. Disponimet për masat e sigurimit, sipas subjektit të rivlerësimit, janë pasojë e vendimmarrjes së gjykatës, nuk cenojnë themelin e vendimit dhe, nëse janë të nevojshme, plotësohen me vendim të gjykatës.

62.2. Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit për to, në raport me situatën e rezultuar nga hetimi administrativ i Komisionit, trupi gjykues vëren se mungesa e disponimit nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me heqjen e masës së sigurisë ndaj të pandehurit në dispozitivin e vendimit penal, vjen në kundërshtim me detyrimin e parashikuar nga neni 389 i Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit: *Me vendimin e pafajësisë a të pushimit, gjykata urdhëron lirimin e të pandehurit të paraburgosur dhe deklaron heqjen e masave të tjera të sigurimit. Në të njëjtën mënyrë disponohet edhe kur vendoset pezullimi me kusht i vendimit.*

⁵³ Po aty.

63. Lidhur me gjetjen e raportit të vlerësimit profesional të hartuar nga KLGj-ja, mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale në aspektin e arsyetimit ligjor, se *në rastet e zgjidhjes së martesës, pjesa arsyetuese paraqitet përgjithësisht teorike, nuk analizohet asnjë provë apo pohim gjyqësor mbi bazën e të cilave gjyqtari të ketë arritur në konkluzionin se padia duhet pranuar*⁵⁴, trupi gjykues konstatoi se raporti i referohet: (i) njërit prej tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti, konkretisht vendimit civil nr. {***}, datë 21.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me palë paditëse A. Z. dhe palë të paditur A. Z., me objekt “Zgjidhje martese”, me të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e padisë; zgjidhjen e martesës midis bashkëshortëve dhe lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim nënës së tyre, paditëses A. Z. etj.; si dhe (ii) dosjes nr. {***} të përzgjedhur me short, që i përket çështjes civile për zgjidhjen e së cilës, subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 28.07.2016, me të cilin ka vendosur pranimin e padisë dhe zgjidhjen e martesës midis bashkëshortëve, paditësit R. M. e së paditurës M. M. dhe lënien e fëmijëve të mitur A. M. dhe R. M. për rritje dhe edukim nënës së tyre, së paditurës M. M. etj.

63.1. Gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me gjetjet e sipërcituara, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *Vendimet për zgjidhjen e martesës kanë një specifikë të ndryshme nga vendimet e tjera civile. Në këto gjykime, personalisht nuk i hyj dhe verifikoj shkaqet e zgjidhjes së martesës, pasi kërkoj të ruhet privatësia e palëve dhe mes tyre, në gjykim, të mos krijohet një situatë konflikti. Për mua, është i mjaftueshëm verifikimi i faktit që marrëdhëniet bashkëshortore janë tronditur deri në atë pikë sa është i pamundur pajtimi dhe vijimi i bashkëjetesës. Si prova në gjykim, palët paraqesin vetëm një certifikatë martese që provojnë ekzistencën e martesës dhe një certifikatë familjare për të verifikuar nëse kanë fëmijë dhe gjykata shprehet për rregullimin e pasojave nga zgjidhja e martesës. Në këto kushte, këto lloj vendimesh, më shumë kanë konsiderata të përgjithshme lidhur me martesën dhe detyrimet e palëve pas zgjidhjes së martesës.*

63.2. Nga verifikimi i vendimeve të referuara nga raporti i KLGj-së, trupi gjykues vëren mangësi në analizën dhe argumentimin e qëndrimit të subjektit të rivlerësimit mbi arsyet për të cilat fëmijët i janë lënë për rritje dhe edukim prindit përkatës. Subjekti nuk ka arsyetuar mbi nevojat e fëmijëve apo faktorët në të cilët ka mbështetur vendimin mbi masën e dhënë të detyrimit ushqimor (në vendimin civil nr. {***}, datë 21.11.2016). Në këto vendime, nuk analizohet asnjë provë apo pohim gjyqësor mbi bazën e të cilave është arritur në konkluzionin se padia duhet pranuar. Në ndryshim nga qëndrimi i subjektit i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjykimit në Kolegj, trupi gjykues vlerësoi se gjykata, edhe në këto raste, ka detyrimin të arsyetojë e shpjegojë bindshëm arsyet që e çojnë atë drejt një vendimmarrjeje të caktuar, për pasojë, u gjetën të drejta konstatimet e raportit të KLGj-së, të cilat janë bërë pjesë e shkakut të ankimit të Komisionerit Publik.

⁵⁴ Faqja 37 e raportit të KLGj-së.

64. Lidhur me gjetjen e raportit të vlerësimit profesional të hartuar nga KLGj-ja, mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale në aspektin e arsytimit ligjor, se *në 1 rast gjykimi të një çështjeje civile, me objekt “Përmbushje detyrimi”, nuk përdoret një metodologji e caktuar në arsytimin e vendimit dhe konstatohet se arsytimi është i qartë, i kuptueshëm, por pa ndonjë analizë të thelluar*, trupi gjykues konstatoi se raporti i referohet vendimit civil nr. {***}, datë 26.04.2014, me palë paditëse shoqëria “{***}” ShPK dhe palë e paditur shoqëria “{***}” ShPK, me objekt “Përmbushje detyrimi”, me të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e padisë dhe lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Subjekti i rivlerësimit nuk ka vlerësuar të japë shpjegime gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, lidhur me këtë gjetje. Nga kontrolli i vendimit të sipërcituar, trupi gjykues vëren se qëndron gjetja e konstatuar nga KLGj-ja në raport, se arsytimi është i qartë, por pa ndonjë analizë të thelluar.
65. Lidhur me gjetjen e raportit të vlerësimit profesional të hartuar nga KLGj-ja, mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale në aspektin e arsytimit ligjor, se *përgjithësisht, në 3 dokumentet dhe 5 dosjet e vëzhguara, gjyqtari nuk citon provat mbi të cilat palët kanë provuar faktet e pretenduara prej tyre*, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime gjatë hetimit administrativ në Komision dhe as gjatë gjykimit në Kolegj, lidhur me këtë gjetje. Nga verifikimi i vendimeve të arsyetuara nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të analizës së dokumenteve ligjore dhe dosjeve të përzgjedhura me short të kryer nga KLGj-ja, trupi gjykues vëren se qëndron konstatimi i organit ndihmës, pasi subjekti i rivlerësimit në këto vendime, nuk i ka cituar provat dhe as analizuar ato në kuadër të pretendimeve të palëve, për rrjedhojë nuk arrihet të qartësohet mbi bazën e cilave prova subjekti i rivlerësimit ka mbështetur vendimmarrjen e tij⁵⁵. Edhe në rastet kur provat evidentohen në vendim, ato vetëm listohen dhe mungon analiza e tyre.
66. Lidhur me gjetjen e raportit të vlerësimit profesional të hartuar nga KLGj-ja, mbi kriterin e vlerësimit të aftësive organizative në aspektin e aftësisë për të kryer procedurat gjyqësore, se *te 1 çështje penale e vëzhguar, planifikimi i seancës së parë gjyqësore është planifikuar për një afat 9 ditë, duke mos u respektuar afati 10-ditor i njoftimit të të pandehurit para datës së zhvillimit të seancës të parashikuar nga neni 333/2 i K. Pr. Penale*⁵⁶, trupi gjykues konstatoi se raporti i referohet çështjes penale nr. {***} akti, datë 12.11.2015, që i përket të pandehurit A. N., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Çështja është zgjidhur nga subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. {***}, datë 10.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Çështja është regjistruar në këtë gjykatë në datën 12.11.2015 dhe, me shortin elektronik të datës 16.11.2015, i është caktuar subjektit të rivlerësimit. Me vendimin e datës 16.11.2015, subjekti i rivlerësimit ka caktuar datën e seancës gjyqësore, e cila do të zhvillohej më datë 25.11.2015. Trupi gjykues vëren se seanca gjyqësore

⁵⁵ Neni 29 i Kodit të Procedurës Civile, parashikon:

“Gjykata mbështet vendimin në provat e paraqitura nga palët ose nga prokurori, të marra në seancë gjyqësore. Gjykata çmon provat që ndodhen në aktet, në bazë të bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e tyre i rrethanave të çështjes”.

⁵⁶ Faqja 39 e raportit të KLGj-së.

është caktuar për një afat prej 9 ditësh, ndërkohë që në nenin 333/1 të Kodit të Procedurës Penale parashikohej se: “Brenda dhjetë ditëve nga depozitimi i kërkesës së prokurorit ose të dëmtuarit akuzues, kryetari i trupit gjykues, i ngarkuar për gjykimin e çështjes, cakton datën e seancës gjyqësore”.

Seanca gjyqësore e datës 25.11.2015 nuk është zhvilluar për shkak se nuk është paraqitur asnjëra prej palëve; prokurori ka qenë i angazhuar në një gjykim tjetër, ndërsa i pandehuri nuk kishte marrë dijeni për datën dhe orën e gjykimit. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit ka shtyrë shqyrtimin gjyqësor, duke caktuar një datë të mëvonshme.

Duke mbajtur në konsideratë nenin 335 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikonte se: “Deri në datën e caktuar për gjykim palët, mbrojtësit dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë të shikojnë sendet e sekuestruara, të shqyrtojnë, në sekretari, aktet dhe dokumentet e mbledhura në fashikullin për shqyrtimin gjyqësor, si dhe të nxjerrin kopje të tyre” – në vlerësim të trupit gjykues, duket se shkelja e afatit 10-ditor për caktimin e seancës gjyqësore, nuk ka sjellë asnjë pasojë për të pandehurin pasi ai nuk e kishte marrë njoftimin për zhvillimin e kësaj seance gjyqësore.

67. Në përfundim, lidhur me gjetjet e raportit të KLGj-së, të cilat u konsideruan të drejta, trupi gjykues evidentoi mangësi të subjektit të rivlerësimit, në aspektin e arsytimit ligjor, në kuptim të nenit 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.
68. Shkaqet e tjera të ankimit të Komisionerit Publik në drejtim të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të patrajtuara në këtë vendim, përfshirë edhe pretendimet për çështjen gjyqësore të adresuar nga denoncuesi P. N., si një ndër tri çështjet e hetuara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk u gjetën të bazuara nga trupi gjykues i Kolegjit. Ndërkaq, trupi gjykues nuk mbajti një qëndrim lidhur me pretendimet e ngritura në dy çështjet e tjera, të adresuara nga denoncuesit A. T. dhe A. R., për sa kohë që ato lidheshin me themelin e çështjes apo aspekte të tjera të procesit të rregullt ligjor e, si të tilla, do t’i nënshtrohen kontrollit gjyqësor, respektivisht të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku ndodhen nën shqyrtim aktualisht.
69. Në vlerësim të trupit gjykues, mangësitë e konstatuara në aspektin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nuk konsiderohen si të mjaftueshme për t’u kualifikuar sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por, për shkak të peshës së veçantë të problematikës së evidentuar në çështjen penale që i përket shtetasit A. C., si një problematikë që buron nga informacionet e ardhura nga institucionet ligjzbatuese, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
70. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet i papërshtatshëm për të vijuar detyrën. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit, çmon se vendimi nr. 479, datë 03.12.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i pabazuar në prova dhe në ligj dhe duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 479, datë 03.12.2021, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Dosti.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 13.02.2025.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi